

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Drejtimin Mësimor

TEKSTIL - KONFEKSIONE

Niveli I

Kodi: D-I-18

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2018

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional “Tekstil - konfeksione”, niveli I.**
 1. Kërkesat e pranimet të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I.
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimimit në drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I.
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimimit në drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I.
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimimit në drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I.
- III. Plani mësimor për drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimimit në drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin dhe konfeksionimin e veshjeve.* Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin mësimor “Tekstil - konfeksione” niveli I, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim arsimit në drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithëshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Tekstil - konfeksione” niveli I, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të kryejë matjet trupore të klientit;
- Të përdorë tabelat e përmasave për femra.
- Të realizojë punimet e dorës.
- Të përzgjedhë materialet e punës;
- Të përzgjedhë mjetet e punës;
- Të përdorë mjetet kryesore të punës në tekstil – konfeksion;
- Të realizojë tegela me forma të ndryshme në format letre;
- Të skicojë modelin për funde, pantallona, bluza, këmisha, fustane;
- Të ndërtojë kallëpet me shenjat përkatëse të referimit për funde, pantallona, bluza, këmisha, fustane;
- Të zgjedhë pëlhurën dhe aksesorët e përshtatshëm për modelin përkatës për funde, pantallona, bluza, këmisha, fustane;
- Të presë funde, pantallona, bluza, këmisha, fustane sipas modelit;
- Të qepë funde, pantallona, bluza, këmisha, fustane sipas modelit
- Të kryejë provën e qëndrimit në trup të fundeve, pantallonave, bluzave, këmishave
- Të kryejë proceset përfundimtare të konfeksionimit të fundeve dhe pantallonave të modeluara.
- Të dekorojë funde, bluza, këmisha, fustane;
- Të realizojë në letër milimetrike një motiv popullor;
- Të endë në telajo një model të projektuar;
- Të respektojë standardet e profesionit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit;
- Të përdorë në mënyrë të pavarur literaturat profesionale.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në drejtimin “Tekstil - konfeksione”, niveli I.

Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Tekstil - konfeksione”, niveli I, e pajis nxënësim me certifikatën e punonjësit gjysëm të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim, me të drejtë për vazhdimin e arsimit në nivelin II të kualifikimit profesional (njëvjeçar), në një

nga profilet mësimore të këtij drejtimi. Ky kualifikim i jep mundësi nxënësit t'i drejtohet tregut të punës si ndihmës në ndërmarrje të ndryshme të prodhimit të veshjeve për burra, gra dhe fëmijë; të qepjes së tekstileve për përdorim shtëpiak si dhe në ndërmarrje të prodhimit dhe konfeksionimit të trikotazheve. Gjithashtu, i jep mundësi nxënësit t'i drejtohet tregut të punës edhe si ndihmës në dyqane të ndryshme artizanale dhe atelie mode.

Me arsimim të mëtejshëm (në nivelin III) nxënësit fitojnë "Maturën shtetërore profesionale" me mundësi për vazhdimin e studimeve të larta universitare dhe pas të mesmes.

I. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin "Tekstil – konfeksione", niveli I

Plani mësimor për drejtimin "Tekstil - konfeksione", Niveli I				
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Niveli I	
			Orët javore/vjetore	
			Klasa 10	Klasa 11
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	14/15 (504/ 540)	11/12 (374/ 408)
1		Gjuhë shqipe	1	1
2		Letërsi	1	1
3		Gjuhë e huaj 1	2	2
4		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(1)	(1)
5		Matematikë	2	2
6		Fizikë	2	-
7		Kimi	-	2
8		Shkencat sociale	2	-
9		Histori	-	2
10		Gjeografi	1	-
11		Teknologji informimi e komunikimi	1	-
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	2	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	10 (360)	8 (272)
1	L-01-017-17	Vizatim teknik	2	-
2	L-10-018-17	Bazat e prerjes	2	3
3	L-10-019-17	Bazat e qepjes	2	2
4	L-10-020-17	Njohuri tekstili dhe trikotazhi	2	1
5	L-10-021-08	Njohuri për makinat e tekstil - konfeksionit	2	-
6	L-10-448-17	Estetika e veshjes dhe njohuri mbi ngjyrat	-	2
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	5 (180)	10 (340)
1	M-10-749-17	Përdorimi i mjeteve të punës dhe qepjet me dorë në rrobaqepësi	36	
2	M-10-1368-17	Qepja me makina qepëse familjare dhe industriale	36	
3	M-10-750-17	Punime përfundimtare të rrobaqepësisë	36	

4	M-10-751-17	Qepja e xhepave dhe e zinxhirëve	36	
5	M-10-1369-17	Konfeksionimi i fundeve	36	
6	M-10-752-17	Qepja e jakave dhe e mëngëve		51
7	M-10-1370-17	Konfeksionimi i bluzave dhe kemishave për femra		70
8	M-10-754-17	Konfeksionimi i pantallonave për femra dhe meshkuj		66
9	M-10-061-17	Konfeksionimi i këmbëve për meshkuj		51
10	M-10-062-17	Dekorimi i veshjeve		51
11	M-10-1371-17	Endja dhe projektimi i modelit në letër milimetrike		51
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	1 (36)	2 (68)
1	M-10-065-08	Qepja e supanjave	36	
2	M-10-066-08	Qepja e qemereve	36	
3	M-10-067-08	Qepja e mostrave		34
4	M-10-068-08	Konfeksionimi i fund - pantallonave		34
5	M-10-069-08	Konfeksionimi i fustaneve		68
6	M-10-070-08	Thurrje me grep dhe me shtiza		34
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1080/ 1116)	31/32 (1054/ 1088)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 10, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 11 viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 1 javë për provimin e praktikës profesionale + 1 javë për provimin e teorisë profesionale).

Një javë mësimore ka jo më shumë 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Tekstil-konfeksione”, niveli I, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit “Tekstil-konfeksione”, niveli I.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Tekstil-konfeksione”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së njëmbëdhjetë, nxënësi i arsimuar në drejtimin profesional “Tekstil-konfeksione”, niveli I, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e ndërtimit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, për çdo vit shkollor, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit I.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Tekstil-konfeksione”, niveli I

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Tekstil-konfeksione”, niveli I, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësisë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;

- rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit I.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Vizatim teknik” (L-01-017-17). Kl. 10 – 72 orë

• Synimet e lëndës “Vizatim teknik”, kl. 10.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Vizatim teknik”, kl.10, nxënësit duhet:

- Të zgjedhin sipas rastit materialet e skicimit.
- Të kryejnë skica të thjeshta
- Të përdorin materialet dhe veglat e vizatimit teknik.
- Të kryejnë vizatime teknike të thjeshta.
- Të përdorin shkrimin teknik.
- Të kryejnë ndërtime të thjeshta gjeometrike në skica dhe vizatime teknike.
- Të lexojnë paraqitjet e objekteve të thjeshta.
- Të paraqesin, me anën e pamjeve, objekte të thjeshta teknike.
- Të skicojnë detale të thjeshta.
- Të lexojnë skica të ndryshme detalesh të thjeshta.
- Të kryejnë vizatime teknike të detaleve të thjeshta sipas skicave të tyre.
- Të lexojnë skica dhe vizatime detalesh,ku janë përdorur paraqitjet me prerje.
- Të paraqesin në aksonometri modele të thjeshta.
- Të paraqesin modele të ndryshme me pikturë teknike.
- Të paraqesin në skica dhe vizatime sipërfaqet e filetuara.
- Të lexojnë në skica dhe vizatime sipërfaqet e filetuara.
- Të vizatojnë bashkime të thjeshta detalesh.
- Të vizatojnë vizatime të thjeshta përmbledhëse.
- Të vizatojnë skema të thjeshta.
- Të lexojnë skema të thjeshta.
- Të vizatojnë kurba gjeometrike (vija të lakuara)

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Vizatim teknik”, kl 10 - 72 orë

Tema 1	Njohuri për vizatimet teknike dhe të skicimit.	4 orë
Tema 2	Materialet,veglat e vizatimit teknik.	2 orë
Tema 3	Shkrimi teknik.	4 orë
Tema 4	Ndërtimet gjeometrike kryesore.	4 orë
Tema 5	Paraqitja e objekteve në disa pamje.	9 orë
Tema 6	Vizatimet e skicimit të detaleve.	3 orë
Tema 7	Vizatimet teknike të detaleve, kryerja e vizatimit sipas skices.	3 orë
Tema 8	Njohuri për vendosjen e përmasave, shkallët e vizatimit.	3 orë
Tema 9	Paraqitjet me prerje.	6 orë
Tema 10	Paraqitjet aksonometrike.	6 orë
Tema 11	Gradimi	6 orë
Tema 12	Paraqitja e filetave në vizatim.	3 orë
Tema 13	Paraqitjet e detaleve të bashkuara	4 orë
Tema 14	Vizatimet përmbledhëse.	6 orë
Tema 15	Vizatimet skematike.	9 orë

2. Lënda “Bazat e prerjes” (L-10-018-17). Kl. 10-72 orë dhe Kl. 11–102 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e prerjes”, kl. 10.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “ Bazat e prerjes”, kl 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë zhvillimin e trupit të njeriut dhe pikat antropometrike për matje në të;
- Të dallojnë difektet e figurës femërore si (shpatullt, vithet, këmbë dhe shpina)
- Të tregojnë ndarjen e trupit të njeriut në pjesë;
- Të përshkruajnë mënyrën e marrjes së masave;
- Të marrin masat në trupin e njeriut;
- Të përdorin tabelat e përmasave;
- Të përshkruajnë mjetet e punës që nevojiten për ndërtimin e kallëpeve;
- Të interpretojnë shenjat që përdoren në skicat dhe kallëpet e prerjes;
- Të nxjerrin nga tabelat e përmasave masat e nevojshme për ndërtimin e fundeve dhe pantallonave;
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së fundit të drejtë;
- Të përshkruajnë mënyrat e transformimit të pencave të fundit
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së fundeve sipas mënyrës së transformimit të pencave
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së fundeve me xhepa (të jashtëm, të brendshëm, filetë)
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së fundeve me gjerësi të ndryshme në pjesën e poshtme;
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së fundeve me pala;
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së fundeve me rrotullim;
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së pantallonave të thjeshta për femra;
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së pantallonave xhins për femra;
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së pantallonave me gjatësi të ndryshme të shtratit.
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së pantallonave me pala për femra;
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së fund-pantallonave për femra.
- Të korrigjojë defektet e pantallonave në varësi të vitheve dhe këmbëve

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e prerjes”, kl. 10 - 72 orë

Tema 1	Anatomia dhe proporcionet e trupit të njeriut	4 orë
Tema 2	Forma dhe qëndrime të figurës femërore	4 orë
Tema 3	Mjetet e punës dhe dhe simbolet e prerjes	3 orë
Tema 4	Masat e trupit dhe tabelat e përmasave	6 orë
Tema 5	Fundi i thjeshtë për femra	9 orë
Tema 6	Transformimi i pencave të fundit	8 orë
Tema 7	Funde me lloje të ndryshme të xhepave	10 orë
Tema 8	Funde me modele të ndryshme	8 orë
Tema 9	Pantallonat e thjeshta për femra	10 orë
Tema 10	Pantallonat e modeluara për femra	6 orë
Tema 11	Fund – pantallonat për femra	4 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e prerjes”, kl. 11.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “ Bazat e prerjes”, kl 11, nxënësit duhet:

- Të marrin masat për trupin bazë (busti);

- Të nxjerrin masat e nevojshme nga tabelat e përmasave;
- Të tregojnë etapat për ndërtimin e skicave të prerjes së shpinës dhe përparësës së bluzës për femra me pencë në sup.
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së shpinës dhe përparësës së bluzës për femra me pencë në sup;
- Të përshkruajnë mëngët dhe zhvillimin e kokës së mëngët
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së shpinës dhe përparësës së bluzës për femra pa penca
- Të ndërtojnë skicën e prerjes së mëngës thjeshtë së bluzës për femra pa penca
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së këmishës për femra me penca dhe pa penca
- Të klasifikojnë llojet e mëngëve për bluza, këmisha dhe fustane
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së mëngëve për bluza, këmisha dhe fustane
- Të klasifikojnë llojet e jakave për bluza, këmisha dhe fustane
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së jakave për bluza, këmisha dhe fustane
- Të përshkruajnë mënyrat e zhvendosjes së pencës së supit të baza e bustit
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së zhvendosjes së pencës së supit të baza e bustit
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së bazës së bustit me mëngë kimono dhe regland
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së shpinës dhe përparësës së fustanit për femra me penca dhe pa penca;
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së fustaneve të modeluara për femra
- Të zhvendosin pensat në pozicione të ndryshme;
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së pantallonave për meshkuj;
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së këmishës për meshkuj (sportive dhe klasike);
- Të kontrollojnë saktësinë e skicave.
- Të dallojnë defekte të skicave;
- Të korigjojnë defektet e pantallonave për burra

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e prerjes”, kl 11 -102 orë**

Tema 1	Busti dhe masat e duhura	4 orë
Tema 2	Bluza për femra me pencë në sup	6 orë
Tema 3	Mëngët, analiza e krahut dhe zhvillimi i kokës së mëngës	6 orë
Tema 4	Bluza për femra pa penca dhe me mëngë	8 orë
Tema 5	Këmisha për femra me penca dhe pa penca	8 orë
Tema 6	Llojet e mëngëve për bluza, këmisha dhe fustane	6 orë
Tema 7	Llojet e jakave për bluza, këmisha dhe fustane	8 orë
Tema 8	Spostimi i pencave të baza e bustit	8 orë
Tema 9	Baza e bustit me mëngë kimono	4 orë
Tema 10	Baza e bustit me mëngë reglan	8 orë
Tema 11	Fustani i thjeshtë për femra	6 orë
Tema 12	Fustane të modeluara për femra	8 orë
Tema 13	Proporcionet, masat dhe tabelat e përmasave për meshkuj	2 orë
Tema 14	Këmisha klasike për meshkuj	6 orë
Tema 15	Këmisha sportive për meshkuj	6 orë
Tema 16	Pantallonat për meshkujt	8 orë

3. Lënda “Bazat e qepjes” (L-10-019-17). Kl. 10 - 72 orë dhe Kl. 11 – 68 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e qepjes”, kl. 10

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e qepjes”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të tregojnë mjetet dhe pajisjet e punës së rrobaqepësit dhe mënyrën e përdorimit të tyre;
- Të përshkruajnë llojet e qepjeve të përkohshme me dorë;
- Të përshkruajnë teknikat e realizimit të qepjeve të përkohshme me dorë;
- Të klasifikojnë pensat dhe të tregojë mënyrën e qepjes e të hekurosjes së tyre;
- Të përshkruajnë teknikat e formimit të mulesave, rrudhave dhe frudave;
- Të tregojnë llojet e palave dhe mënyrën e qepjes së tyre;
- Të përshkruajnë mënyrën e përgatitjes së filetove dhe të qepjeve me to;
- Të tregojnë llojet e supanjave dhe teknikat e qepjes së tyre;
- Të rendisin pjesët e veshjes që pastrohen me anë të mostrave;
- Të përshkruajnë teknikat e përgatitjes dhe të qepjes së mostrave;
- Të përshkruajnë teknikat e realizimit të llojeve të ndryshme të xhepave
- Të tregojnë llojet e bordurave të këmishave dhe teknikat e qepjes së tyre;
- Të përshkruajnë teknikat e qepjes së jakave;
- Të përshkruajnë teknikat e qepjes së hapjes së mëngëve, të përgatitjes së kapakëve, manshetave dhe të qepjes së tyre në mëngë.
- Të përshkruajnë teknikat e qepjes së mëngëve;
- Të përshkruajnë teknikat e qepjes së zinxhirëve;
- Të përshkruajnë teknikat e përgatitjes dhe të qepjes së qemerëve;
- Të tregojnë mënyrat e kthimit të palës së veshjeve.
- Të rendisin etapat e qepjes së fundit për femra;
- Të përshkruajnë proceset e qepjes së fundit
- Të rendisin etapat e qepjes së pantallonave të thjeshta për femra;
- Të përshkruajnë proceset e qepjes së pantallonave të thjeshta për femra;
- Të rendisin etapat e qepjes së fund-pantallonave për femra;
- Të përshkruajnë proceset e qepjes së fund-pantallonave për femra;

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e qepjes”. kl. 10 - 72 orë

Tema 1	Mjetet e punës	2 orë
Tema 2	Punimet me dorë	6 orë
Tema 3	Rrudhat dhe palat	4 orë
Tema 4	Filetot	4 orë
Tema 5	Supanjat	4 orë
Tema 6	Mostrat	4 orë
Tema 7	Xhepat	6 orë
Tema 8	Jakat	8 orë
Tema 9	Mëngët	8 orë
Tema 10	Zinxhirat	6 orë
Tema 11	Kthimi i palës	2 orë
Tema 12	Qepja e fundit për femra	6 orë
Tema 13	Qepja e pantallonave të thjeshta për femra	6 orë
Tema 14	Qepja e fund – pantallonave për femra	6 orë

• **Synimet e lëndës “Bazat e qepjes”, kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e qepjes”, kl. 11, nxënësit duhet:

- Të rendisin etapat e qepjes së bluzës me penca për femra;
- Të përshkruajnë proceset e qepjes së bluzës me penca për femra;
- Të rendisë etapat e montimit dhe qepjes së mëngës;
- Të rendisë etpat e qepjes së bluzës pa penca dhe me mëngë;
- Të përshkruajë proceset e qepjes së bluzës pa penca dhe me mëngë;
- Të përshkruajë proceset e qepjes së disa modeleve të mëngëve për këmisha dhe fustane;
- Të rendisë etapat e qepjes së jakave për bluza, këmisha dhe fustane;
- Të përshkruajë proceset e qepjes së disa prej modeleve të jakave për bluza, këmisha dhe fustane;
- Të rendisë etapat e qepjes së bluzës me mëngë kimono;
- Të përshkruajë proceset e qepjes së bluzës me mëngë kimono;
- Të rendisë etapat e qepjes së bluzës me mëngë renglan;
- përshkruajë proceset e qepjes së bluzës me mëngë renglan;
- Të rendisin etapat e qepjes së fustanit të thjeshtë;
- Të përshkruajnë proceset e qepjes së fustanit të thjeshtë;
- Të rendisin etapat e qepjes së disa prej fustaneve të modeluara;
- Të përshkruajnë proceset e qepjes së disa prej fustaneve të modeluara;
- Të rendisin etapat e qepjes së këmishës klasike për meshkuj;
- Të përshkruajnë proceset e qepjes së këmishës klasike për meshkuj;
- Të përshkruajnë proceset e qepjes së këmishës sportive për meshkuj;
- Të rendisin etapat e qepjes së pantallonave klasike për meshkuj;
- Të përshkruajnë proceset e qepjes së pantallonave klasike për meshkuj;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e qepjes”, kl. 11- 68 orë**

Tema 1	Qepja e e bluzës me penca për femra	4 orë
Tema 2	Montimi dhe qepja e mëngës	4 orë
Tema 3	Qepja e bluzës pa penca dhe me mëngë	6 orë
Tema 4	Qepja e këmishës me penca dhe pa penca për femra	6 orë
Tema 5	Qepja e mëngëve për bluza, këmisha dhe fustane	4 orë
Tema 6	Qepja e jakave për bluza, këmisha dhe fustane	4 orë
Tema 7	Qepja e bluzës me mëngë kimono	4 orë
Tema 8	Qepja e bluzës me mëngë renglan	4 orë
Tema 9	Qepja e fustanit te thjeshte	6 orë
Tema 10	Qepja e fustaneve të modeluara	6 orë
Tema 11	Qepja e këmishës klasike për meshkuj	6 orë
Tema 12	Qepja e këmishës sportive për meshkuj	6 orë
Tema 13	Qepja e pantallonave klasike për meshkuj	8 orë

4. Lënda “Njohuri tekstili dhe trikotazhi” (L-10-020-17). Kl. 10-72 orë dhe Kl.11-34 orë

• Synimet e lëndës “Njohuri tekstili dhe trikotazhi”, kl. 10

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri tekstili dhe trikotazhi”, kl 10, nxënësit duhet:

- Të listojnë karakteritikat kryesore të fibrave që përdoren në industrinë e tekstileve.
- Të tregojnë klasifikimin e fibrave dhe përbërjen kimike të tyre.
- Të përcaktojnë fibrën e pambukut si fibër tekstili.
- Të vizatojnë fibrën e pambukut, pasi e ka parë në mikroskop.
- Të listojnë vetitë e fibrave të pambukut.
- Të listojnë vetitë e fibrave të lirit, kërpi, jutës.
- Të listojnë vetitë e fibrave të leshit.
- Të provojnë si reagon leshi ndaj reagentëve kimikë.
- Të listojnë llojet e leshrave.
- Të përshkruajnë metodat e krefjes së pambukut dhe të leshit.
- Të listojnë llojet e fibrat artificiale.
- Të listojnë llojet e fibrave sintetike.
- Të listojnë vetitë e këtyre fibrave.
- Të tregojnë çfarë është filli dhe karakteristikat e tij.
- Të listojnë treguesit fiziko-mekanikë të fillit dhe mënyrën e përdorimit të tij në tekstil.
- Të dallojnë fillin për ind nga filli për bazë.
- Të tregojnë ç’është pëlhura.
- Të listojnë rrugën e realizimit të pëlhurës.
- Të dallojnë llojet ethurjeve në pëlhurë.
- Të tregojnë proceset përpunimit të teksileve.
- Të listojnë vetitë e tekstileve.
- Të përcaktojnë llojet e marketimit dhe etiketimit të tekstileve.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri tekstili dhe trikotazhi”, kl. 10-72 orë

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për fibrat tekstile	4 orë
Tema 2	Pambuku	6 orë
Tema 3	Liri. Kërpi. Juta	4 orë
Tema 4	Leshi	4 orë
Tema 5	Mëndafshi	4 orë
Tema 6	Fibrat minore (vegjeta dhe minerake)	4 orë
Tema 7	Fibrat artificiale	3 orë
Tema 8	Fibrat sintetike	3 orë
Tema 9	Filli	7 orë
Tema 10	Filaturimi i fillit	6 orë
Tema 11	Përgatitjet e fillit për tezgjah	6 orë
Tema 12	Pëlhura	8 orë
Tema 13	Përpunimi i tekstileve	7 orë
Tema 14	Vetitë e tekstileve	4 orë
Tema 15	Marketimi dhe etiketimi i tekstileve	2 orë

- **Synimet e lëndës “ Njohuri tekstili dhe trikotazhi”, kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri tekstili dhe trikotazhi”, kl 11, nxënësit duhet:

- Të dallojnë trikotazhet nga pëlhurat
- Të përshkruajnë si realizohen thurjet trikotazh.
- Të dallojnë thurjet trikotazh të bazës dhe thurjet trikotazh të indit.
- Të listojnë vetitë fiziko-mekanike të trikotazheve.
- Të llogarisin koeficientin e elasticitetit të trikotazheve.
- Të listojnë llojet e makinave trikotazh.
- Të realizojnë paraqitjen grafike të thurjeve të trikotazheve.
- Të demonstrojnë proceset e përpunimit të trikotazhit.
- Të përcaktojnë llojet e marketimit dhe etiketimit të trikotazheve.
- Të përshkruajnë standartet dhe kushtet teknike të tekstileve.
- Të listojnë lëkurat dhe zëvendësuesit e tyre.
- Të përshkruajnë procesin e përpunimit të lëkurës

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri tekstili dhe trikotazhi”, kl.11-34 orë**

Tema 1	Trikotazhet, ndërtimi dhe vetitë e tyre.	4 orë
Tema 2	Llojet e makinave të trikotazhit	4 orë
Tema 3	Prodhimi i trikotazheve	4 orë
Tema 4	Karakteristikat e trikotazhit sipas llojeve të thurjes	6 orë
Tema 5	Përpunimi i trikotazhit.	4 orë
Tema 6	Marketimi dhe etiketimi i trikotazheve.	4 orë
Tema 7	Standartet dhe kushtet teknike.	4 orë
Tema 8	Lëkurat dhe zëvendësuesit e tyre	4 orë

5. Lënda “Njohuri për makinat e tekstil - konfeksionit” (L-10-021-08). Kl. 10 – 72 orë

- **Synimet e lëndës “Njohuri për makinat e tekstil - konfeksionit”, kl. 10**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri për makinat e tekstil - konfeksionit”, kl 10 , nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë detalet e makinave;
- Të tregojnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave të qepjes së drejtë
- Të tregojnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave të qepjes tegel zig-zag;
- Të tregojnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave syzator;
- Të përshkruajnë mënyrat e rregullimit të defekteve të thjeshta;
- Të tregojnë ndërtimin e makinave të proceseve ndihmëse;
- Të tregojnë ndërtimin e makinave hekurosëse;
- Të tregojnë pajisjet që përdoren për kontrollin e tekstileve.
- Të tregojnë makinat që përdoren për prerjen e tekstileve.
- Të tregojnë ndërtimin e një makine të thjeshtë tezgjahu;
- Të tregojnë ndërtimin e makinave të qepjes së trikotazheve;
- Të përshkruajnë makinat dhe pajisjet që përdoren për kontrollin dhe prerjen e tekstileve.
- Të listojnë rregullat e sigurimit teknik në përdorimin e makinave të tekstil-konfeksione;
- Të përshkruajnë rregullat e mirëmbajtjes së makinave të tekstil-konfeksione;

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri për makinat e tekstil - konfeksionit”, kl. 10 - 72 orë**

Tema 1	Metalet dhe njohuri për pjesët e makinave.	5 orë
Tema 2	Njohuri për makinat e qepjes së drejtë	10 orë
Tema 3	Përdorimi i makinave të qepjes së drejtë.	6 orë
Tema 4	Njohuri për makinat e qepjes zig-zag.	6 orë
Tema 5	Njohuri për makinat qepëse syzator.	4 orë
Tema 6	Defektet në makinat qepëse dhe rregullimi i tyre.	9 orë
Tema 7	Njohuri për makinat e proceseve ndihmëse	6 orë
Tema 8	Njohuri për makinat hekurosëse.	4 orë
Tema 9	Njohuri për paisjet e kontrollit të tekstilit	4 orë
Tema 10	Njohuri për makinat e prerjes së tekstilit.	4 orë
Tema 11	Njohuri për makinat e tezgjahut të thjeshtë.	6 orë
Tema 12	Njohuri për makinat e qepjes së trikotazheve.	6 orë
Tema 13	Mirëmbajtja dhe sigurimi teknik i makinave të tekstil-konfeksion	2 orë

6. Lënda “Estetika e veshjes dhe njohuri mbi ngjyrat” (L-10-448-17). Kl. 11 – 68 orë

Synimet e lëndës “Estetika e veshjes dhe njohuri mbi ngjyrat”, kl. 11

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Estetika e veshjes dhe njohuri mbi ngjyrat”, kl.11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë objektin e studimit të estetikës .
- Të përshkruajnë historikun e veshjeve.
- Të listojnë funksionin estetik dhe praktik të veshjeve.
- Të përshkruajnë shijet estetike të veshjeve në periudha të ndryshme.
- Të përshkruajnë llojet e veshjeve sipas gjinisë
- Të përshkruajnë llojet e veshjes sipas stilit.
- Të përshkruajnë veçoritë dhe dallimet e skicës artistike dhe skicës teknike të veshjeve;
- Të realizojë një album me veshje sipas gjinisë dhe stilit
- Të përshkruajë origjinën dhe karakteristikat e veshjeve popullore
- Të përshkruajnë klasifikimin e veshjeve popullore.
- Të listojnë veshjet popullore sipas veçorive krahinore
- Të tregojnë rolin e prerjes dhe zbukurimeve në veshjet popullore
- Të shpjegojnë rëndësinë e ngjyrave në veshje
- Të shpjegojnë zërthimin e dritës në spektrin e ngjyrave
- Të realizojnë ngjyrat e dyta dhe të treta nëpërmjet përzierjes së ngjyrave të para
- Të identifikojnë dhe përshkruajë ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta
- Të dallojnë kontrastin e ngjyrave
- Të realizojnë kombinime të ndryshme të kontrastit të ngjyrave
- Të përshkruajnë rëndësinë e kartelës së ngjyrave

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Estetika e veshjes dhe njohuri mbi ngjyrat”, kl. 11 - 68 orë

Tema 1	Objekti i studimit të estetikës	2 orë
Tema 2	Estetika e veshjes në periudha të ndryshme historike	6 orë
Tema 3	Funksioni estetik dhe praktik i veshjeve.	4 orë
Tema 4	Linjat e veshjes sipas gjinisë dhe llojit	8 orë
Tema 5	Veshjet popullore shqiptare dhe karakteristikat e tyre	8 orë
Tema 6	Klasifikimi i veshjeve popullore	8 orë
Tema 7	Prerjet dhe zbukurimet në veshjet popullore	6 orë
Tema 8	Rëndësia e ngjyrave në veshje	2 orë
Tema 9	Zbërthimi i dritës në spektrin e ngjyrave	2 orë
Tema 10	Ngjyrat e para, të dyta dhe të treta	6 orë
Tema 11	Ngjyrat e ngrohta dhe ngjyrat e ftohta	6 orë
Tema 12	Kombinimi dhe kontrasti i ngjyrave	8 orë
Tema 13	Kartela e ngjyrave	2 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Përdorimi i mjeteve të punës dhe qepjet me dorë në rrobaqepësi”

Drejtimi: Tekstil - konfeksione

Niveli: I

Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRDORIMI I MJETEVE TË PUNËS DHE QEPJET ME DORË NË RROBAQEPËSI	M-10-749-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për përdorimin e mjeteve të punës me qëllim prerjen, qepjen, ildisjen dhe konfeksionimin e tekstileve.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përdor mjetet për matje dhe shënime në rrobaqepësi.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për prerje.- Përzgjedhja e materialeve të punës- Përgatitja e tavolinës për prerje.- Përdorimi i metrit shirit të rrobaqepësit.- Përdorimi i vizoreve.- Përdorimi i sapunit shkruar (shkumësi i shënimit).- Përdorimi i gjilpërave me kokë.- Përdorimi i rrotës kopjuese- Përdorimi i kurbalinjës.- Përdorimi i tabakëve prej letre.- Përdorimi i tabelave të masave.- Pastrimi i vendit të punës- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prerjen e tekstileve sipas procedurave standarde.- të përzgjedhë materialet e duhura- të përgatisë si duhet tavolinën për prerje- të përdorë metrin shirit për marrjen e masave në trupin e njeriut,	

-
- të përdorë metrin shirit për realizimin e vizatimit mbi copë
 - të përdorë metrin shirit gjatë prerjes.
 - të përdorë vizoret për vizatimin mbi objekt, sipas përmasave të dhëna
 - të përdorë sapunin shkruar për vizatimin e saktë të objektit në copë.
 - të përdorë gjilpërat me kokë për fiksime të përkohëshme gjatë provës dhe gjatë qepjes.
 - të përdorë rrotën kopjuese për të kopjuar bazat prej letre.
 - të përdorë kurbalinjën në përputhje me pjesët e harkuara të veshjeve.
 - të përdorë tabakët prej letre për nxjerrjen e kallëpeve.
 - të përdorë tabelat e masave duke marrë masat bazë trupore.
 - të pastrojë vendin e punës
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi përdor mjetet dhe materialet e punës për prerje dhe për qepje me dorë.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepje
- Përzgjedhja e materialeve të punës
- Përdorimi i gërshërës së dorës.
- Përdorimi i gërshërëve të vogla.
- Përdorimi i gërshërës mesatare.
- Përdorimi i gërshërëve të mëdha.
- Përdorimi i gërshërëve të dhëmbëzuara.
- Përdorimi i gërshërës elektrike.
- Përdorimi i gishtëzës.
- Përdorimi i gjilpërave të dorës.
- Përdorimi i penjëve të ndryshëm.
- Mirëmbajtja e mjeteve të punës
- Pastrimi i vendit të punës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përdorimin e mjeteve dhe materialeve të punës për qepje.
- të përzgjedhë drejt materialet e punës
- të përdorë gërshëret e dorës për prerjet e tekstilit.
- të përdorë gërshëret e vogla për hapjet e vrimave.
- të përdorë gërshëret mesatare për prerjet e shkurtra të tekstilit
- të përdorë gërshëret e mëdha për prerje të gjata të pjesëve kryesore të veshjeve.
- të përdorë gërshëret e dhëmbëzuara për prerje zbukuruese

- mbi bazën e rregullave përkatëse.
- të përdorë gërsërët elektrike në prerjen e pjesëve të veshjeve në formë shumë shtresore.
- të përdorë gishtëzën sipas rregullave të saj të përdorimit.
- të përdorë gjilpërat e dorës sipas llojit të materialit për veshje.
- të përdorë penjtë sipas ngjyrës së copës.
- të mirëmbajë mjetet e punës
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- të kujdeset për mjetet dhe materialet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi përdor mjetet e punës për hekurosje.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për hekurosjen.
- Përzgjedhja e materialeve të punës
- Përdorimi i tavolinës për hekurosje.
- Përdorimi i jastëkut të hekurosjes me mbështetje.
- Përdorimi i jastëkut në formë katërkëndëshi këndrejt.
- Përdorimi i jastëkut të rrumbullakët.
- Përdorimi i jastëkut petashuq.
- Përdorimi i drurit të përkulur.
- Përdorimi i hekurit me peshë të lehtë dhe me peshë të rëndë.
- Përdorimi i hekurave me avull dhe me gradues temperature.
- Përdorimi i presave për hekurosje.
- Mirëmbajtja e mjeteve të hekurosjes
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përdorimin e mjeteve të punës për hekurosje sipas procedurave standarte.
- të përdorë tavolinën për hekurosjen e materialeve të qepurave.
- të përdorë jastëkun e hekurosjes me mbështetese për pjesët e përkulura të veshjeve (supe, jaka, mëngë etj).
- të përdorë jastëkun në formë katërkëndëshi, për hekurosjen e pjesëve në gjatësi.
- të përdorë jastëkët në formë të rrumbullakët për hekurosje sipas llojit të veshjeve.
- të përdorë jastëkun petashuq për hekurosjen e supeve dhe sidomos të kokës së mëngës.
- të përdorë drurin e përkulur për hekurosjen e fortesave dhe pjesëve përpara të xhakëtës apo të palltos.
- të përdorë hekurin me peshë të lehtë dhe me peshë të rëndë sipas llojit të materialit të tekstilit.

- të përdorë hekurat me avull dhe me gradues temperature sipas llojit të materialit të tekstilit.
- të përdorë presat për hekurosje të njëtrajtshme sipas standardeve të kërkuara (me njomje dhe temperaturë të pandryshueshme).
- të mirëmbajë mjetet e hekurosjes
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

RM 4 Nxënësi përdor pajisjet ndihmëse të rrobaqepsisë.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për përdorimin e paisjeve ndihmëse.
- Përdorimi i manikineve.
- Përdorimi i varëseve të rrobave.
- Përdorimi i kaçavidave.
- Përdorimi i pincetës.
- Përdorimi i furçës.
- Përdorimi i pikatores.
- Përdorimi i fshesës elektrike.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe paisjet ndihmëse sipas procedurave standarde.
- të përdorë manikinë sipas masave trupore.
- të përdorë varëset e rrobave sipas llojit të veshjeve të konfeksionuara.
- të përdorë kaçavidat për lirimin apo shtrëngimin e vidave të makinës qepëse.
- të përdorë pincetën për përshkimin e fijeve.
- të përdorë furcën për pastrimin e mbeturinave dhe pushrave, sipas llojit të veshjes së konfeksionuar
- të përdorë pikatoren e vajit për vajisjen e makinës qepëse sipas rregullave përkatëse.
- të përdorë fshesën elektrike për pastrimin e vendit të punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

RM 5 Nxënësi kryen ildisjet e veshjeve

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës
- Përzgjedhja e materialeve kryesore dhe ndihmëse
- Ildisja e shenjave për qepje
- Ildisja e bashkimit të dy pjesëve të materialit
- Ildisja e jakës
- Ildisja e qemerit

- Ildisja e mëngëve
- Ildisja e palës
- Pastrimi i vendit të punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për ildisjen e veshjeve
- të ildisë shenjat e qepjeve sipas modelit të shënuar
- të ildisë bashkimin e dy pjesëve të materialit sipas shenjave për qepje
- të ildisë jakën sipas formës së dhënë
- të ildisë qemerin sipas shenjave shënuese
- të ildisë mëngën sipas shenjave shënuese
- të ildisë palën sipas shenjave shënuese
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare

të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

RM 6 Nxënësi kryen qepjen me dorë të palave të veshjeve

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen me dorë të palave të ndryshme
- Qepja e palës së pantallonave
- Qepja e palës së fundit
- Qepja e palës së mëngës
- Pastrimi i vendit të punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen me dorë të palave të ndryshme
- të qepë si duhet palën e pantallonave
- të qepë si duhet palën e fundit
- të qepë si duhet palën e mëngës
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë i rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 7 Nxënësi realizon qepjen e vrimave dhe të kopsave me

dorë në veshje të ndryshme

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për bërjen e vrimave dhe të kopsave me dorë në veshje të ndryshme.
- Përzgjedhja e materialeve kryesore dhe ndihmëse.
- Bërja e matjeve dhe shënimeve për vrimat e kopsave.
- Hapja e vrimave të kopsave.
- Qepja e vrimave të kopsave me dorë.
- Shënimi i vendeve për qepjen e kopsave.
- Teknikat e qepjes me dorë të kopsave të llojeve të ndryshme
- Pastrimi i vendit të punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për bërjen e vrimave dhe të kopsave me dorë në veshje të ndryshme .
- të përzgjedhë drejt materialet kryesore dhe ndihmëse
- të bëjë matje dhe shënime të sakta për vrimat e kopsave.
- të bëjë hapjen e vrimave të kopsave.
- të qepë me dorë vrimat e kopsave.
- të përzgjedhë drejt materialet kryesore dhe ndihmëse.
- të bëjë shënime të sakta të vendeve të kopsave.
- të kryejë si duhet qepjen me dorë e kopsave të llojeve të ndryshme.
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në repartet e konfeksionimit të tekstileve.
- Instruktori i praktikës, ose teknologu i repartit duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve përgatitore për përdorimin e mjeteve të punës dhe qepjes me dorë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore, për përdorimin e mjeteve të punës për prerjen, qepje dhe përmbarimin e veshjeve, përdorimin e pajisjeve ndihmëse, si dhe qepjet me dorë në rrobaqepësi.
- Instruktori i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e prerjes, qepjes, përmbarimit të veshjeve dhe qepjeve me dorë në rrobaqepësi.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- reparti i rrobaqepësisë.
 - mjete pune për prerjen e tekstileve.
 - reparti për qepjen e veshjeve, sipas kërkesave të prodhimit.
 - tabelë masash, revista mode, udhëzues të ndryshëm, rregullore,
 - standarte, kallëpe, etj.
-

2. Moduli “Qepja me makina qepëse familjare dhe industriale”

Drejtimi: Tekstil - konfeksione
Niveli: I
Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	QEPJA ME MAKINA QEPËSE FAMILJARE DHE INDUSTRIALE	M-10-1368-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për qepje të ndryshme me makina qepëse familjare dhe për të kryer veprimtari përgatitore për qepjen në makineritë e ndryshme industriale si: syzator, tegel i drejtë, bërje vrimash, qepje kopsash, qëndisje, makineri hekurosëse, etj.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen procese përgatitore për përdorimin e makinave qepëse familjare Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës- Përgatitja për punë e makinës qepëse familjare.- Kontrolli i pjesëve të makinës qepëse familjare.- Lëvizja dhe praktikimi i këmbëve në makinë.- Vënia në lëvizje e makinës qepëse pa përdorur tekstil.- Qepja në tekstil pa përdorur pe.- Pastrimi i vendit të punës dhe i makinave qepëse.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës në makinat qepëse familjare.- të përgatisë për punë makinat qepëse.- të kontrollojë pjesët e makinës qepëse familjare.- të përdorë makinën qepëse me lëvizjen e këmbëve.- të kryejë lëvizje të shpejta dhe të njëtrajtshme të këmbëve- të vërë në lëvizje makinën pa përdorur tekstil.- të kryejë qepjen në makinë pa përdorur pe.- të pastrojë vendin e punës dhe makinat qepëse.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit sipas manualit përkatës.	

RM 2 Nxënësi kryen qepje në makinat qepëse të tegelave me forma të ndryshme ne format letre me gjilpërë dhe pa suvajkë .

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepje në makinë.
- Përzgjedhja e materialeve të punës
- Përgatitja për punë e makinës qepëse
- Kontrolli i pjesëve të makinës qepëse
- Vendosja dhe fiksimi i gjilpërës në makinë.
- Regjistrimi i hapit të tegelit.
- Regjistrimi i shpejtësisë së makinës
- Kryerja e tegelave në vijë të drejtë pa ndalesa
- Kryerja e tegelave në vijë të drejtë dhe kënde pa ndalesë dhe duke rrotulluar letrën
- Kryerja e tegelave me kthesë pa ndalesë duke bërë rrotullime në drejtim të akrepave të orës
- Kryerja e tegelave të drejtë dhe me kthesë pa ndalesë
- Kryerja e tegelave të zbukurimit
- Pastrimi i vendit të punës dhe makinës qepëse.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepje në makinën sipas një radhe të caktuar veprimi.
- të përzgjedhë drejt materialet e punës
- të përgatisë për punë makinat qepëse.
- të kontrollojë pjesët e makinës qepëse
- të vendosë dhe të fiksojë gjilpërën në makinë.
- të regjistrojë hapin e tegelit sipas procesit dhe llojit të tekstilit.
- të regjistrojë shpejtësinë e makinës sipas proceseve
- të kryej qepjen e tegelave të drejtë pa ndalesë me çipimet mbi linjë
- të kryej qepjen e tegelave të drejtë dhe kënde me gjilpërë në kënde të vendosur thellë
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për përgatitjen dhe qepjen e jakave dhe mëngëve të ndryshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për përgatitjen dhe qepjen e jakave dhe mëngëve.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi përgatitjen e jakave me rrotullim të lehtë, jakave të ngritura, jakës së këmishës, jakës shall, si dhe mëngëve të këmishës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi montimin e mëngëve dhe jakave në veshje me mostër si dhe montimi i mëngëve dhe jakave në veshje që nuk kanë mostër.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- repart rrobaqepsie;
 - pajisjet dhe mjetet e punës së rrobaqepsisë;
 - lëndë të para dhe ndihmëse për përgatitjen dhe qepjen e jakave dhe mëngëve.
 - pankarta, makete, udhëzues, katalogë të rrobaqepsisë, etj.
-

7. Moduli “Konfeksionimi i bluzave dhe këmishave për femra”

Drejtimi: Tekstil – konfeksione

Niveli: I

Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KONFEKSIONIMI I BLUZAVE DHE KËMISHAVE PËR FEMRA	M-10-1370-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për konfeksionim e bluzave dhe këmishave për femra	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 të drejtimit “Tekstil-konfeksione”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi pret bluzë të thjeshtë për femra.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.- Skicimi i bluzës së thjeshtë.- Kontrolli i skicave- Vendosja e shenjave përkatëse të referimit.- Prerja e kallëpeve të bluzës bazë.- Përgatitja e pëlhurës për prerje.- Vendosja e kallëpeve mbi pëlhurë- Shënimi mbi pëlhurë i pjesëve të bluzës.- Prerja e pëlhurës.- Prerja e frazelinës.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prerjen e bluzës.- të ndërtojë skicat e prerjes së pjesëve të bluzës të thjeshtë sipas përmasave reale.- të bëjë kontrollin e saktësisë së skicave- të vendosë shenjat e referimit në skicë.- të presë kallëpet e bluzës të thjeshtë.- të përgatisë pëlhurën për prerje.- të vendosë kallëpet mbi pëlhurë duke ekonomizuar lëndën e parë.- të shënojë mbi pëlhurë pjesët e bluzës.- të presë në pëlhurë pjesët përbërëse të bluzës.	

-
- të presë në frazelinë jakën, dhe mostrat e bluzës.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi përgatit bluzën e thjeshtë për provë

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Kopjimi i shënimeve nga pjesa e lartme në atë të poshtme.
- Frazelinimi i jakës, dhe mostrës së bluzës
- Ildisja e pencave të bluzës.
- Bashkimi me ildi i shpinës me përparësen e bluzës.
- Kryerja e provës
- Rregullimi i bluzës pas kryerjes së provës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përgatitjen e bluzës për provën e parë të bluzës.
- të kopjojë me penjë-kopjues shënimet nga pjesa e lartme në atë të poshtme, tek shpina dhe përparësja e bluzës.
- të frazelinojë jakën, dhe mostrën e bluzës.
- të ildisë pensat e bluzës.
- të bashkojë me ildi shpinën me përparësen e bluzës.
- të kryej provën e qëndrimit në trup të bluzës.
- të kryej rregullimin e bluzës pas kryerjes së provës
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi qep bluzën e thjeshtë

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Qepja e pensave të shpinës dhe përparëses së bluzës.
- Hekurosja e pensave.
- Bashkimi i shpinës me përparësen e bluzës.
- Hekurosja e pjesëve anësore të bluzës.
- Përgatitja e mostrave
- Përgatitja e jakës.
- Ildisja e jakës në bluzë.
- Ildisja e mostrave së bashku me jakën në bluzë
- Qepja e mostrave së bashku me jakën në bluzë.
- Përgatitja e mëngëve.
- Ildisja e mëngëve.
- Qepja e mëngëve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e bluzës deri në provën e dytë të bluzës.
- të qepë pensat e shpinës dhe përparësës së bluzës me tegel.
- të hekurosë pensat.
- të bashkojë shpinën me përparësen e bluzës me tegel.
- të hekurosë pjesët anësore të bluzës.
- të përgatisë mostrat
- të përgatisë jakën.
- të ildisë jakën në bluzë.
- të ildisë mostrat së bashku me jakën në bluzë.
- të qepë mostrat së bashku me jakën në bluzë.
- të qepë anësoret e mëngëve.
- të qepë hapjen e thjeshtë të mëngëve
- të përgatisë kapakët dhe ti montojë ato në mëngë.
- të qepë tegelat e molesave tek koka e mëngës.
- të ildisë mëngën në bluzë.
- të qepë mëngën në bluzë.
- të kryej rregullimin e bluzës pas kryerjes së provës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi pret këmishën për femra.**Përmbajtja:**

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për prerjen e këmishës.
- Përzgjedhja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse.
- Skicimi i këmishës.
- Vendosija e shenjave të referimit
- Kontrolli i skicave.
- Prerja e kallëpeve të këmishës.
- Përgatitja e tekstilit për prerje
- Vendosija e kallëpeve mbi tekstil.
- Shënimi mbi tekstil i pjesëve të këmishës.
- Prerja e tekstilit.
- Prerja e jakës, këmbazës dhe dorezave.
- Pastrimi i vendit të punës
- Rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për prerjen e këmishës.
- të përzgjedhë lëndën e parë dhe materialet ndihmëse.
- të ndërtojë skicat e prerjes së pjesëve të këmishës.
- të vendosë shenjat e referimit
- të kontrollojë saktësinë e skicave.

- të presë kallëpet e këmishës, sipas shenjave të referimit
 - të përgatisë tekstilin për prerje, në drejtimin e duhur.
 - të vendosë kallëpet mbi pëlhurë.
 - të shënojë mbi tekstil pjesët e këmishës.
 - të presë në tekstil pjesët përbërëse të këmishës
 - të presë në fortesë jakat, këmbëzat dhe dorezat e këmishës.
 - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjeno-sanitare
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 5 Nxënësi përgatit për provë këmishën për femra.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse.
- Kopjimi i shënimeve.
- Frazelinimi i jakës dhe dorezave së këmishës
- Ildisja e këmishës.
- Kryerja e provës.
- Rregullimi i këmishës, pas kryerjes së provës.
- Pastrimi i vendit të punës
- Rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përgatitjen e këmishës për provë.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse për realizimin e provës së këmishës.
- të kopjojë shënimet nga pjesa e lartme në atë të poshtme të këmishës.
- të frazelinojë jakën dhe dorezat e këmishës.
- të ildisë supanjën me shpinën dhe përparëset e këmishës.
- të ildisë shpinën me përparësen e këmishës.
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të këmishës.
- të kryejë rregullimin e këmishës pas kryerjes së provës.
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjeno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 6 Nxënësi qep këmishën për femra.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen e këmishës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse.
- Përgatitja e supanjave.
- Qepja e supanjës me këmishën.

- Qepja e bordurave të mbërthimit të këmishës.
- Hekurosja e bordurave.
- Përgatitja e jakës.
- Qepja e jakës në këmishë.
- Përgatitja e mëngëve.
- Qepja e mëngëve në këmishë.
- Konfeksionimi i këmishës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e këmishës.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse për qepjen e këmishës
- të përgatisë supanjat.
- të qepë supanjat me shpinën e këmishës.
- të qepë supanjat me përparëset e këmishës.
- të frazelinojë bordurat e përparëseve.
- të ildisë bordurat.
- të qepë bordura e mbërthimit të këmishës.
- të hekurosë bordurat.
- të qepë jakën e poshtme me atë të sipërmen.
- të kthejë jakën dhe ta ildisë atë.
- të përgatisë këmbëzën e jakës.
- të bashkojë këmbëzen e jakës me jakën
- të qepë jakën në këmishë.
- të qepë hapjen e mëngëve
- të përgatisë dorezat në mëngë.
- të qepë dorezat në mëngë.
- të ildisë mëngën në këmishë.
- të qepë mëngët në këmishë.
- të konfeksionojë këmishën me të gjitha pjesët përbërëse të saj.
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 7 Nxënësi kryen proceset përfundimtare të qepjes së bluzës dhe këmishës për femra.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse.
- Përgatitja e xhepit.
- Qepja e xhepit.
- Ildisja e palës në bluzë dhe këmishë.
- Qepja e palës në bluzë dhe këmishë.
- Qepja e vrimave të kopsave dhe kopsave .

- Qepja e tegelave të sipërm dekorues tek mostrat.
- Pastrimi i brëndshëm i bluzës dhe këmishës.
- Hekurosja përfundimtare
- Pastrimi i vendit të punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së bluzës dhe këmishës.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së bluzës dhe këmishës.
- të përgatisë xhepin e këmishës sipas modelit të kërkuar.
- të ildisë xhepin.
- të qepë xhepin.
- të ildisë palën e bluzës dhe këmishës.
- të qepë me makinë palën e bluzës dhe këmishës.
- të qepë me makinë vrimat për kopsa.
- të qepë kopsat.
- të qepë tegela të sipërm dekorues tek mostrat.
- të pastrojë bluzën dhe këmishën nga fijet mbetura nga qepja
- të hekurosë bluzën dhe këmishës e qepur.
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjeno-sanitare
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe te organizohen vizita njohëse në ndërmarrje të konfeksionit.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që është e mundur demonstrimet konkrete për modelimin, prerjen dhe qepjen e bluzave dhe këmishave për femra.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për modelimin, prerjen dhe qepjen e bluzave dhe këmishave për femra.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demostrimit praktik të aftësive dhe njohurive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Komplet i veglave dhe materialeve për modelimin, prerjen, qepjen e bluzave dhe këmishave për femra .
 - Udhëzues, rregullore për kushtet teknike për modelimin, prerjen, qepjen e bluzave dhe këmishave për femra.
-

8. Moduli “Konfeksionimi i panatallonave për femra dhe meshkuj”

Drejtimi: Tekstil - konfeksione

Niveli: I

Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KONFEKSIONIMI I PANTALLONAVE PËR FEMRA DHE MESHKIJ	M-10-754-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për modelimin, prerjen, qepjen e pantallonave për femra dhe meshkuj.	
Kohëzgjatja e modulit	66 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 të drejtimit “Tekstil-konfeksione”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi merr masat për pantallona për femra dhe meshkuj Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për marrjen e masave.- Përzgjedhja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse.- Marrja e masave- Kontrolli i masave.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për marrjen e masave.- të përzgjedhë lëndën e parë dhe materialet ndihmëse.- të marrë masat në trupin e njeriut- të kontrollojë masat e marra.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>RM 2 Nxënësi pret pantallona të thjeshta për femra dhe meshkuj. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për prerjen e pantallonave.- Ndërtimi i skicave.- Vendosja e shenjave të referimit- Kontrolli i skicave.- Prerja e kallëpeve.	

- Vendosja e kallëpeve mbi pëlhurë
- Shënimi mbi pëlhurë i pjesëve të pantallonave.
- Prerja e pëlhurës.
- Prerja e astarit dhe e përforcuesit të qemerit.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prerjen e pantallonave.
- të ndërtojë skicat e prerjes së pjesëve të pantallonave të thjeshta.
- të vendosë shenjat e referimit.
- të kontrollojë saktësinë e skicave.
- të presë kallëpet e pantallonave të thjeshta sipas skicës.
- të vendosë kallëpet mbi pëlhurë në drejtimin gjatësor të pëlhurës.
- të shënojë mbi pëlhurë, sipas kallëpeve, pjesët e pantallonave.
- të presë në pëlhurë pjesët e pantallonave.
- të presë astaret për xhepat anësorë dhe qemerin.
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi përgatit pantallonat për femra dhe meshkuj, për provë.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Kopjimi i shënimeve.
- Frazelinimi i qemerit.
- Ildisja e pantallonave.
- Kryerja e provës së parë.
- Rregullimi i pantallonave pas kryerjes së provës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për provën e pantallonave.
- të kopjojë me penjë-kopjues shënimet nga pjesa e lartme në atë të poshtme të pantallonave.
- të frazelinojë qemerin.

- të ildisë pensat e pantallonave.
- të bashkojë me ildi shpinën me përparësen e pantallonave.
- të kryejë provën e parë të qëndrimit në trup të pantallonave.
- të kryej rregullimin e pantallonave pas kryerjes së provës.
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi qep pantallonat për femra

Përmbajtja

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen e pantallonave.
- Përzgjedhja e materialeve të punës
- Fikson materialin ngjitës me pëlthurë
- Qepja e patentit
- Qepja e pantallonave
- Hekuros dhe finalizon pantallonat për femra

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitjë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e pantallonave.
- të përzgjedhë materialet e punës
- të fiksojë si duhet materialin ngjitës me pëlthurë
- të qepë patentin sipas shënimit
- të qepë pantollonat sipas modelit
- të hekurosë dhe finalizojë pantallonat për femra
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 5 Nxënësi qep pantallonat për meshkuj.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen e pantallonave.
- Qepja e pensave të shpinës.
- Hekurosja e pensave dhe palës.
- Qepja e xhepave anësorë të drejtë.
- Qepja e xhepave me dy fileto.
- Qepja e shpinës me përparësen e pantallonave.
- Hekurosja e këmbëve të pantallonave.
- Përgatitja e pjesëve të sallkisë.
- Qepja e sallkisë.
- Ildisja e astarëve të xhepave me belin e pantallonave.
- Përgatitja e qemerit.
- Përgatitja e ylykëve.

- Qepja e qemerit dhe ylykëve në pantallona.
- Qepja e harkut të kavallos.
- Pastrimi i vendit të punës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e pantallonave.
- të qepë me makinë pensat e shpinës.
- të hekurosë pensat e shpinës.
- të ildisë palën në përparëset.
- hekurosë pensat dhe palat.
- të qepë xhepat e drejtë anësorë.
- të qepë xhepat me dy fileto në shpinat e pantallonave.
- të qepë shpinën me përparësen e pantallonave, duke bashkuar shenjat përkatëse të referimit
- të hekurosë këmbët e pantallonave, duke krijuar vijën e hekurit.
- të përgatisë pjesët e sallkisë.
- të qepë sallkinë në pantallona, sipas parametrave të kërkuar.
- të ildisë astaret e xhepave me belin e pantallonave.
- të përgatisë qemerin.
- të përgatisë ylykët.
- të qepë ylykët dhe qemerin në pantallona.
- të qepë harkun e kavallos.
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 6 Nxënësi kryen proceset përfundimtare të qepjes së pantallonave për meshkuj.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së pantallonave.
- Qepja e ylykut të qëndrës së shpinës.
- Qepja e palës.
- Qepja e birës së kopsës në qemer.
- Qepja e kopsave në sallki dhe qemer.
- Izolimi i pjesëve të brendshme të pantallonave.
- Pastrimi i brëndshëm i pantallonave.
- Hekurosja përfundimtare e pantallonave.
- Pastrimi i vendit të punës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së pantallonave.
- të qepë ylykun e qemerit në qëndër të shpinës.
- të ildisë palën sipas shënimit
- të qepë palën.
- të qepë vrimën e kopsës në qemer me dorë ose makinë.
- të qepë kopsat në sallki dhe në qemer.
- të bëjë izolimin e penjëve të pëlhurës në pjesën e brëndëshme të pantallonave me dorë ose makinë.
- të pastrojë pantallonat nga penjtë në pjesën e brëndëshme të tyre.
- të hekurosë pantallonat.
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjeno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepsisë si dhe të organizohen vizita njohëse në ndërmarrje të konfeksionit.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që është e mundur demonstrimet konkrete për modelimin, prerjen, qepjen e pantallonave për femra dhe meshkuj.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për modelimin, prerjen, qepjen e pantallonave për femra dhe meshkuj.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demonstrimit praktik të aftësive dhe njohurive që ata kanë fituar.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Komplet i veglave dhe materialeve për modelimin, prerjen, qepjen e pantallonave për femra dhe meshkuj.
 - Udhëzues, rregullore për kushtet teknike për modelimin, prerjen, qepjen e pantallonave për femra dhe meshkuj.
-

9. Moduli “Konfeksionimi i këmishave për meshkuj”

Drejtimi: Tekstil - konfeksione

Niveli: I

Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	KONFEKSIONIMI I KËMISHAVE PËR MESHKIJ	M-10-061-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të konfeksionuar këmisha për meshkuj.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 të drejtimit “Tekstil-konfeksione”	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi pret këmishën për meshkuj. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për prerjen e këmishës.- Përzgjedhja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse.- Skicimi i këmishës.- Vendosja e shenjave të referimit- Kontrolli i skicave.- Prerja e kallëpeve të këmishës.- Përgatitja e tekstilit për prerje- Vendosja e kallëpeve mbi tekstil.- Shënimi mbi tekstil i pjesëve të këmishës.- Prerja e tekstilit.- Prerja e fortesave.- Pastrimi i vendit të punës- Rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për prerjen e këmishës.- të përzgjedhë lëndën e parë dhe materialet ndihmëse.- të ndërtojë skicat e prerjes së pjesëve të këmishës.- të vendosë shenjat e referimit- të kontrollojë saktësinë e skicave.- të presë kallëpet e këmishës, sipas shenjave të referimit- të përgatisë tekstilin për prerje, në drejtimin e duhur.- të vendosë kallëpet mbi pëlhurë.- të shënojë mbi tekstil pjesët e këmishës.	

-
- të presë në tekstil pjesët përbërëse të këmishës
 - të presë në fortesë jakat, këmbëzat dhe dorezat e këmishës.
 - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi përgatit për provë këmishën për meshkuj.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse.
- Kopjimi i shënimeve.
- Frazelinimi i jakës dhe dorezave së këmishës
- Ildisja e këmishës.
- Kryerja e provës.
- Rregullimi i këmishës, pas kryerjes së provës.
- Pastrimi i vendit të punës
- Rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përgatitjen e këmishës për provë.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse për realizimin e provës së këmishës.
- të kopjojë shënimet nga pjesa e lartme në atë të poshtme të këmishës.
- të frazelinojë jakën dhe dorezat e këmishës.
- të ildisë supanjën me shpinën dhe përparëset e këmishës.
- të ildisë shpinën me përparësen e këmishës.
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të këmishës.
- të kryejë rregullimin e këmishës pas kryerjes së provës.
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi qep këmishën për meshkuj.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen e këmishës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse.
- Përgatitja e supanjave.
- Qepja e supanjës me këmishën.
- Qepja e bordurave të mbërthimit të këmishës.
- Hekurosja e bordurave.

- Përgatitja e jakës.
- Qepja e jakës në këmishë.
- Përgatitja e mëngëve.
- Qepja e mëngëve në këmishë.
- Konfeksionimi i këmishës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e këmishës.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse për qepjen e këmishës
- të përgatisë supanjat.
- të qepë supanjat me shpinën e këmishës.
- të qepë supanjat me përparëset e këmishës.
- të frazelinojë bordurat e përparëseve.
- të ildisë bordurat.
- të qepë bordura e mbërthimit të këmishës.
- të hekurosë bordurat.
- të qepë jakën e poshtme me atë të sipërmen.
- të kthejë jakën dhe ta ildisë atë.
- të përgatisë këmbëzën e jakës.
- të bashkojë këmbëzen e jakës me jakën
- të qepë jakën në këmishë.
- të qepë hapjen e mëngëve
- të përgatisë dorezat në mëngë.
- të qepë dorezat në mëngë.
- të ildisë mëngën në këmishë.
- të qepë mëngët në këmishë.
- të konfeksionojë këmishën me të gjitha pjesët përbërëse të saj.
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjeno-sanitare
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi kryen proceset përfundimtare të qepjes së këmishës për meshkuj.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse.
- Përgatitja e xhepit.
- Qepja e xhepit.
- Ildisja e palës së këmishës.
- Qepja e palës së këmishës.
- Qepja e vrimave të kopsave.
- Qepja e kopsave.

- Pastrimi i këmishës.
- Hekurosja përfundimtare.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së këmishës.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së këmishës.
- të përgatisë xhepin e këmishës sipas modelit të kërkuar.
- të ildisë xhepin.
- të qepë xhepin.
- të ildisë palën e këmishës.
- të qepë me makinë palën e këmishës.
- të qepë me makinë vrimat për kopsa.
- të qepë kopsat.
- të pastrojë këmishën nga fijet mbetura nga qepja
- të hekurosë këmishës e qepur.
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjeno-sanitare
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të rrobaqepsisë
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për prerjen dhe qepjen e këmishës për meshkuj.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për prerjen dhe qepjen e këmishës.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi prerjen e pjesëve përbërëse të këmishës në pëlhurë dhe fortesë, si dhe për realizimin e veprimeve mbi qepjen e këmishës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- repart rrobaqepsie; pajisjet dhe mjetet e punës së rrobaqepësit;
 - lëndë të para dhe ndihmëse për prerjen dhe qepjen e këmishës për meshkuj.
 - pankarta, makete, udhëzues, katalogë të rrobaqepsisë, etj.
-

10. Moduli “Dekorimi i veshjeve”

Drejtimi: Tekstil - konfeksione

Niveli: I

Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	DEKORIMI I VESHJEVE	M-10-062-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer dekorimin e veshjeve me mënyra të ndryshme, me dorë dhe me makina qepëse.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 të drejtimit “Tekstil-konfeksione”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Nxënësi kryen qëndisje me mbushje me dorë Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vëndit dhe mjeteve të punës për qëndisjen me mbushje.- Përzgjedhja e materialeve të punës- Skicimi i modelit- Vendosija e tekstilit në gjergjef.- Qëndisja me mbushje e tekstilit.- Finalizimi i qëndisjes.- Pastrimi i vëndit të punës.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vëndin dhe mjetet e punës për qëndisjen me mbushje.- të përzgjedhë materialet e punës sipas modelit dhe llojit të tekstilit- të skicojë modelin.- të vendosë saktë tekstilin në gjergjef.- të qëndisë me mbushje pëlhurën sipas modelit.- të finalizojë qëndisjen.- të pastrojë vëndin e punës duke respektuar rregullat e higjienës.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi kryen qëndisjen zinxhir, me dorë

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qëndisjen zinxhir të tekstilit.
- Vizatimi i modelit në pëlhurë.
- Vendosja e tekstilit në gjergjef.
- Fiksimi i materialit ngjitës në tekstil.
- Qëndisja zinxhir e tekstilit.
- Finalizimi i procesit të qëndisjes zinxhir.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qëndisjen zinxhir
- të vizatojë modelin në pëlhurë.
- të vendosë tekstilin në gjergjef.
- të fiksojë materialin ngjitës në tekstil.
- të kryejë qëndisjen zinxhir në tekstil.
- të finalizojë procesin e qëndisjes zinxhir.
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat e higjienës
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi kryen qëndisje me çarje, me makinë.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qëndisjen me çarje.
- Përzgjedhja e materialit për qëndisje .
- Skicimi i modelit me motive të ndryshme.
- Vendosja e tekstilit në gjergjef.
- Fiksimi i materialit ngjitës në tekstil.
- Qëndisja me çarje me makinë, sipas modelit.
- Finalizimi i qëndisjes me çarje.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qëndisjen me çarje.
- të përzgjedhë materialin e duhur për qëndisje.
- të vizatojë modelin me motive të ndryshme.
- të vendosë pëlhurën në gjergjef.
- të fiksojë materialin ngjitës në tekstil.
- të kryejë qëndisjen me çarje sipas modelit.
- të finalizojë qëndisjen me çarje.

- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat e higjienës
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi dekoron tekstin me tegela dekorues

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës në makinat për tegelat dekorues.
- Përzgjedhja e materialit për dekorim
- Skicimi i modelit me tegela dekorues .
- Vendosja e tekstit në makinën qepëse.
- Qepja me tegela dekorues në makinë.
- Finalizimi i dekoracioneve.
- Pastrimi i vëndit të punës.
- Mirëmbajtja e makinave qepëse.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës në makinat për tegelat dekorues.
- të përgatisë për punë makinat për tegelat dekorues .
- të skicojë modelin me tegela dekorues
- të vendosë tekstin në makinën qepëse sipas skicës përkatëse.
- të kryejë qepjen me tegela dekorues në makinë.
- të finalizojë dekoracionet.
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat e higjienës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 5 Nxënësi kryen dekorimin e me aksesorë

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës
- Përzgjedhja e modelit dekorues
- Përzgjedhja e materileve dekorues
- Përcaktimi i teknikave të dekorimit
- Skicimi në tekstil i modelit të dekorimit
- Dekorimi me shirita mendafshi
- Dekorimi me fije leshi
- Dekorimi me lëkurë
- Dekorimi me rruaza
- Dekorimi me temina
- Finalizimi i dekorimeve.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për dekorimin e veshjeve.
- të përzgjedhë modelin dekorues sipas veshjes dhe tekstilit
- të përzgjedhë materialin dekorues në përshtatje me modelin
- të përcaktojë teknikën e dekorimit sipas sipas modelit
- të skicojë në tekstil modelin e dekorimeve.
- të kryejë dekorimin me shirita mendafshi
- të kryejë dekorimin me fije leshi,
- të kryejë dekorimin me lëkurë.
- të kryejë dekorimin me rruaza,
- të kryejë dekorimin me temina
- të finalizojë dekorimet.
- të pastroje vendin e punës.
- të pastroje dhe mirëmbajë vendin e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të qepjes së veshjeve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të dekorimit të veshjeve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për realizimin e dekorimeve të ndryshme me dorë dhe me makina qepëse.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi
- i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e dekorimeve të ndryshme në veshje.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Repart me makina të ndryshme qepëse.
 - Mjete pune për qëndisjen me dorë dhe me makina të ndryshme qepëse.
 - Lëndë të para dhe ndihmëse për qëndisjen dhe dekorimin veshjeve.
 - Katalogë me modele të ndryshme qëndisje dhe dekoracioni.
-

11. Moduli “Endja dhe projektimi i modelit në letër milimetrike”

Drejtimi: Tekstil - konfeksion
Niveli: I
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	ENDJA DHE PROJEKTIMI I MODELIT NË LETËR MILIMETRIKE	M-10-1371-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari përgatitore për endjen dhe projektimin e modelit me qëllim realizimin me endje të këtij modeli.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 të drejtimit “Tekstil-konfeksione”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përgatit telajon e gatshme për endje Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për përgatitjen e telajos me gozhda.- Përzgjedhja e fillit bazë dhe ind.- Përcaktimi i hapësirave midis gozhdëve në varësi të fillit bazë dhe ind të përzgjedhur.- Vendosja e gozhdëve- Vendosja e fillit bazë te gozhdat- Endja e fillit ind në telajo një po një jo- Endja e fillit ind në telajo dy me dy- Endja e fillit ind në telajo dy me një- Heqja e endjes nga telajo dhe krahasimi i tre llojeve të endjes- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedist. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendi dhe mjetet e punës për përgatitjen e telajos me gozhda.- të përzgjedhë fillin bazë dhe ind.- të përcaktojë hapësirat midis gozhdëve në varësi të fillit bazë dhe ind të përzgjedhur.- të vendosë gozhdët në telajo- të vendosë fillin bazë te gozhdët- të ndajë sipërfaqen në tre hapësira	

-
- të realizojë endjen e fillit ind në telajo një po një jo
 - të realizojë endjen e fillit ind në telajo dy me dy
 - të realizojë endjen e fillit ind në telajo dy me një
 - të krahasojë tre llojet e endjes
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedist.

RM 2 Nxënësi realizon endje në telajo duke kombinuar fije me përbërje, madhësi dhe ngjyra të ndryshme.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e fillit bazë
- Përzgjedhja e fijeve me përbërje, madhësi dhe ngjyra të ndryshme
- Përgatitja e telajos me gozhdë
- Vendosja e fillit bazë në telajo
- Renditja e fijeve që do të enden sipas një ideje për kombinimin e fijeve dhe ngjyrave
- Endja e fijeve sipas një ideje paraprake
- Përfundimi i endjes dhe heqja nga telajo
- Karakteristikat e endjes
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjeteve të punës.
- të përzgjedhë fillin bazë
- të përzgjedhë fije me përbërje, madhësi dhe ngjyra të ndryshme
- të vendosë gozhdët në telajo
- të vendosë fillin bazë në telajo
- të rendisë fijet që do të enden sipas një ideje për kombinimin e fijeve dhe ngjyrave
- të realizojë endjen e fijeve sipas një ideje paraprake
- të përfundojë endjen dhe ta heqë nga telajo
- të vëzhgojë dhe shpjegojë karakteristikat e endjes endjes
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

RM 3 Projektimi i modelit në letër milimetrike

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e motivit (motiv gjeometrik popullor)
- Vizatimi dhe thjeshtëzimi i motivit me laps mbi një fletë të zakonshme
- Ngjyrosja e motivit mbi letër

- Përcaktimi i përmasave të motivit në letrën milimetrike në varësi të sipërfaqes së telajos për endje
- Përcaktimi i kontureve të motivit
- Vizatimi i motivit hap pas hapi në letrën e milimetruar
- Përcaktimi i raportit të ngjyrave të motivit mbi letrën milimetrike
- Përfundimi i detajeve të modelit të vizatuar mbi letrën milimetrike
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedist

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjeteve të punës.
- të përzgjedhë motivin (motiv gjeometrik popullor)
- të vizatojë duke e thjeshtësuar motivin me laps mbi një fletë të zakonshme
- të ngjyrosë motivin mbi letër
- të përcaktojë përmasat e motivit në letrën milimetrike në varësi të sipërfaqes së telajos për endje
- të përcaktojë konturet e motivit
- të vizatojë motivin hap pas hapi në letrën e milimetruar
- të përcaktojë raportin e ngjyrave të motivit mbi letrën milimetrike
- të përfundojë detajet e modelit të vizatuar mbi letrën milimetrike
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

RM 4 Nxënësi realizon modelin e projektuar në letër milimetrike nëpërmjet endjes në telajo.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për prodhimin e tekstilit.
- Llogaritja e sasinë së nevojshme të fijeve bazë
- Përzgjedhja e sasinë së nevojshme të fijeve dhe ngjyrave për endjen e motivit
- Përcaktimi i hapësirave midis gozhdave në varësi të fillit bazë dhe ind të përzgjedhur.
- Përgatitja e telajos me gozhdë
- Vendosja e fillit bazë në telajo
- Endja e motivit duke ndjekur modelin e letrës milimetrike.
- Mbyllja e endjes dhe heqja nga telajo
- Lidhja e thekëve në të dyja anët
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e tekstileve sipas kartës teknologjike.
- të llogarisë sasinë e nevojshme të fijeve bazë
- të përzgjedhë sasinë së nevojshme të fijeve dhe ngjyrave për endjen e motivit
- të përcaktojë hapësirat midis gozhdave në varësi të fillit bazë dhe ind të përzgjedhur.
- të përgatisë telajon me gozhdë
- të vendosë fillin bazë në telajo
- të endë motivin duke ndjekur modelin e letrës milimetrike.
- të mbyllë endje dhe ta heqë nga telajo
- të lidhë thekët në të dyja anët e tekstilit të endur
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në laboratorin e tekstilit dhe në klasë
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve përgatitore të përgatitjes së telajos, vendosjes së fillit bazë, endjes dhe realizimit të modelit në letrën milimetrike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për realizimin e modelit në letrën milimetrike dhe realizimit të tij në tekstilin e endur.
- Instruktori i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mbajtjen pastër të vendit të punës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve përgatitore për realizimin e modelit në letrën milimetrike dhe endjes së tekstilit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Telajo e gatshme prej druri (kornizë)
 - Gozhdë, çekiç, fije të ndryshme tekstile, letër milimetrike, lapsa me ngjyra, etj.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të modulit
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

1. Moduli “Qepja e supanjave”

Drejtimi: Tekstil - konfeksione

Niveli: I

Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	QEPJA E SUPANJAVE	M-10-065-08
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të përgatitur dhe qepur supanja të llojeve të ndryshme	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi qep supanjë rrethore të qafës.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për përgatitjen e supanjave rrethore të qafës.- Përzgjedhja e materialeve të punës- Vendosja e materialit ngjites në shpinën dhe përparësen e supanjës së sipërme.- Bashkimi i supeve të shpinës dhe përparëses së supanjës.- Bashkimi i supeve të shpinës dhe përparëses së astarit.- Bashkimi i supanjës me veshjen sipas harkut të supanjës.- Bashkimi i astarit me harkun e qafës.- Cikatja e harkut.- Kthimi i astarit në pjesën e brëndëshme të veshjes.- Ildisja e astarit me harkun e supanjës.- Qepja me dorë e astarit.- Heqja e ildive.- Hekurosja e supanjës.- Pastrimi i vendit të punës- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë mjetet dhe vëndin e punës për të përgatitur dhe qepur supanja të harkuara të qafës.	

-
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës
 - të frazelinojë pjesët e supanjave të sipërme.
 - të bashkojë supet e shpinës me ato të përparësës të supanjës.
 - të bashkojë supet e astarit.
 - të qepë supanjën me veshjen sipas formës së saj.
 - të qepë astarin në harkun e qafës dhe të cikasë harkun.
 - të kthejë astarin nga brënda.
 - të rrotullojë lehtë astarin dhe ta ildisë harkun e qafës.
 - të ildisë astarin mbi tegelin e bashkimit të supanjës me veshjen, duke e mbuluar tegelin.
 - të qepë me dorë astarin në pjesën e brëndëshme të veshjes.
 - të heqë ilditë.
 - të hekurosë supanjën.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi qep supanjë katrore të qafës.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për përgatitjen e supanjave me kënd të drejtë të qafës.
- Përzgjedhja e materialeve të punës
- Vendosja e materialit ngjites në supanjat e sipërme.
- Bashkimi i supeve të supanjave të sipërme.
- Bashkimi i supeve të supanjave të poshtme.
- Qepja e supanjave sipas formës katrore të dekoltesë.
- Cikatja e qosheve të këndeve të drejta të dekoltesë.
- Kthimi i supanjës.
- Ildisja e supanjës, duke rrotulluar lehtë supanjën e lartme.
- Bashkimi i supanjës së lartme me veshjen sipas linjës së drejtë të veshjes.
- Ildisja e supanjës së poshtme me veshjen.
- Qepja me dorë e supanjës së poshtme.
- Heqja e ildive.
- Hekurosja e supanjës.
- Pastrimi i vendit të punës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe vëndin e punës për të përgatitur dhe qepur supanja katrore të qafës.
- të përzgjedhë materialet e punës
- të bashkojë supet e supanjave të shpinës me ato të përparësës.
- të qepë supanjën e lartme me atë të poshtme sipas

formave katrore të dekoltesë.

- të kthejë supanjën nga ana e mbarë.
- të ildisë dhe qepë me tegel pjesën e drejtë të supanjës së lartme me atë të veshjes.
- të ildisë pjesën e drejtë të supanjës së poshtme me veshjes duke mbuluar tegelin e bashkimit.
- të qepë me dorë supanjën e poshtme në pjesën e brëndëshme të veshjes.
- të heqë ilditë.
- të hekurosë supanjën.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi qep supanja të supeve.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për përgatitjen e supanjës së këmishës.
- Përzgjedhja e materialeve të punës
- Vendosja e pjesës së drejtë të shpinës brënda pjesëve të dreja të dy supanjave.
- Qepja e shpinës me supanajat.
- Hekurosja e shpinës me supanjën.
- Ildisja dhe qepja e supeve të supanjës së poshtme me supet e përparëseve të këmishës.
- Ildisja dhe qepja e supeve të supanjës së lartme me supet e përparëseve të këmishës.
- Heqja e penjëve.
- Hekurosja e supanjës.
- Pastrimi i vendit të punës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe vëndin e punës për të përgatitur dhe qepur supanjë e këmishës.
- të përzgjedhë materialet e punës
- të vendosë pjesën e drejtë të shpinës brënda pjesëve të dreja të dy supanjave.
- të qepë shpinën me supanajat.
- të hekurosë shpinën e qepur me supanajat.
- të ildisë dhe qepë supet e supanjës së poshtme me supet e përparëseve të këmishës.
- të ildisë dhe qepë supet e supanjës së lartme me supet e përparëseve të këmishës.
- të heqë penjtë.
- të hekurosë supanjën.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi qep supanja të ijeve.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për përgatitjen e supanjave të ijeve.
- Përzgjedhja e materialeve të punës
- Ildisja dhe qepja e supanjës së sipërme me veshjen (fund ose pantallona).
- Ildisja e supanjës së sipërme me veshjen.
- Qepja e supanjës së sipërme me veshjen.
- Vendosja e zinxhirit.
- Ildisja dhe qepja e supanjës së poshtme në linjën e belit.
- Kthimi i supanjës në pjesën e brëndëshme të veshjes.
- Ildisja e supanjës së poshtme mbi tegelin e bashkimit të supanjës me veshjen.
- Qepja e supanjës në pjesën e brëndëshme të veshjes.
- Heqja e ildive.
- Hekurosja e supanjës.
- Pastrimi i vendit të punës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe vëndin e punës për të përgatitur dhe qepur supanja të ijeve.
- të përzgjedhë materialet e punës
- të ildisë dhe qepë supanjën esipërme me atë të poshtme duke lënë të hapur pjesën për zinxhirin.
- të ildisë dhe qepë supanjën e sipërme me veshjen.
- të vendosë zinxirin në supanjë duke filluar nga veshja.
- të ildisë dhe qepë supanjën e poshtme.
- të kthejë supanjën e poshtme.
- të ildisë supanjën e poshtme mbi duke e mbuluar tegelin e bashkimit.
- të heqë ilditë.
- të hekurosë supanjën.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të rrobaqepsisë.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për përgatitjen dhe qepjen e supanjave të qafës, supeve dhe ijeve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për përgatitjen dhe qepjen e supanjave të supeve, qafës dhe ijeve.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së

	<p>makinerive dhe pajisjeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi përgatitjen dhe qepjen e supanjave të qafës, ijeve dhe supeve.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - repart rrobaqepsie; - pajisjet dhe mjetet e punës së rrobaqepësit; - lëndë të para dhe ndihmëse për përgatitjen dhe qepjen e supanjave. - pankarta, makete, udhëzues, katalogë të rrobaqepësisë, etj.

2. Moduli “Qepja e qemereve”

Drejtimi: Tekstil - konfeksione

Niveli: I

Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	QEPJA E QEMEREVE.	M-10-066-08
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të përgatitur dhe qepur qemere të llojeve të ndryshme	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranimit	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi qep qemerin e thjeshë.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për përgatitjen dhe qepjen e qemerit.- Përzgjedhja e materialeve të punës- Prerja e qemerit dhe e përforcuesit.- Vendosja e përforcuesit në qemer.- Ildisja dhe qepja e qemerit me belin e veshjes.- Qepja e dy fundeve të qemerit.- Kthimi I qosheve të pjesëve fundore të qemerit.- Kthimi dhe palosja e qemerit.- Ildisja e pjesës së kthyer mbi tegelin e qepjes.- Qepja me tegel dekorativ e qemerit.- Heqja e ildive.- Hekurosja e qemerit.- Pastrimi i vendit të punës- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e qemerit.- të përzgjedhë materialet e duhura të punës- të rendisë llojet e qemerit.- të tregojë sa më i gjatë pritet qemeri se perimetri i belit.- të shpjegojë pse pritet më i gjatë qemeri se perimetri i belit.	

-
- të shpjegojë përse vendoset përforcuesi në qemer.
 - të tregojë llojet e përforcuesve të qemerit.
 - të presë qemerin.
 - të vendosë përforcuesin në qemer.
 - të vendosë anën e mbarë të qemerit mbi anën e mbarë të veshjes dhe të ildisë qemerin.
 - të qepë qemerin në belin e veshjes.
 - të mbyllë dy fundet e qemerit me tegel.
 - të kthejë qoshet e dy pjesëve fundore të qemerit.
 - të kthejë qemerin.
 - të palosë qemerin duke e shtypur me hekur.
 - të kthejë dhe ildisë anën tjetër të qemerit mbi tegelin e qepjes.
 - të qepë me tegel dekorativ qemerin.
 - të heqë ilditë.
 - të hekurosë qemerin.
 - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi qep qemerin me formë.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për përgatitjen dhe qepjen e qemerit.
- Përzgjedhja e materialeve të punës
- Prerja e qemerit dhe e përforcuesit.
- Vendosja e përforcuesit në qemer.
- Përgatitja e qemerit.
- Ildisja dhe qepja e qemerit me belin e veshjes.
- Ildisja e pjesës së kthyer mbi tegelin e qepjes.
- Qepja me tegel dekorativ e qemerit.
- Heqja e ildive.
- Hekurosja e qemerit.
- Pastrimi i vendit të punës
- Zbatimi i rregullve të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e qemerit me formë.
- të përzgjedhë materialet e punës
- të presë qemerin.
- të vendosë përforcuesin në qemer.
- të vendosë dy anët e mbara të qemerit mbi njëra tjetrën dhe të qepë pjesën e lartme të tij sipas formës.
- të kthejë qemerin.
- të ildisë pjesën e lartme të qemerit.

- të vendosë anën e mbarë të qemerit mbi anën e mbarë të veshjes dhe të ildisë qemerin.
- të qepë qemeri në belin e veshjes.
- të mbyllë dy fundet e qemerit me tegel.
- të kthejë qoshet e dy pjesëve fundore të qemerit.
- të kthejë qemerin.
- të palosë qemerin duke e shtypur me hekur.
- të kthejë dhe ildisë anën tjetër të qemerit mbi tegelin e qepjes.
- të qepë me tegel dekorativ qemerin.
- të heqë ilditë.
- të hekurosë qemerin.
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi qep linjën e belit me mostër.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen e linjes së belit me mostër të drejtë (fjongo), ose fileto.
- Hekurosja dhe dhënia e formës fjongos - mostër.
- Qepja e fjongos.
- Palosja e dyfundeve të fjongs.
- Kthimi i fjangos në pjesën e brëndëshme të fundit.
- Rrotullimi i lehtë i saj brënda fundit.
- Ildisja e saj.
- Fiksimi i fjongos.
- Hekurosja e belit të fundit.
- Vendosja e mbërtheckave.
- Prerja e filetos.
- Qepja e filetos.
- Khimi i filetos.
- Rrotullimi lehtë i filetos.
- Fiksimi i filetos.
- Hekurosja e belit të fundit.
- Vendosja e mbertheckave.
- Pastrimi i vendit të punës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e linjës së belit me mostër.
- të rendisë llojet e mostrave që përdoren për linjën e belit.
- të hapë me hekur pjesën e poshtme të fjongos duke i dhenë formë.

- të vendosë mbi linjën e belit pjesën e ngushtë të fjongos-mostër.
- të qepë me tegel fjongon.
- të palosë dy fundet e fjongos nga brënda.
- të kthejë fjongon në anën e brëndëshme
- të rrotullojë lehtë fjongon dhe ta shtypë.
- të ildisë fjongon me belin.
- të fiksojë fjongon në pensat dhe qepjet anësore.
- të hekurosë belin.
- të vendosë mbërtheckat çift në qemer.
- të presë fileton,
- të qepë fileton.
- të kthejë me rrotullim të lehtë fileton.
- të ildisë fileton.
- të fiksojë fjongon në pensat dhe qepjet anësore.
- të hekurosë belin.
- të vendosë mbërtheckat çift në qemer.
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi qep linjën e belit me llastik.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen e linjës së belit me llastik.
- Kthimi i pjesës së lartme të veshjes.
- Qepja me dy tegela e pjesës së kthyer.
- Krijimi i hapsirës për llastikun.
- Prerja e llastikut.
- Futja e llastikut në tunel.
- Mbivendosja e dy skajeve të llastikut dhe qepja e tyre.
- Mbyllja e hapjes për llastikun.
- Pastrimi i vendit të punës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen linjës së belit me llastik.
- të kthejë pjesën e lartme të veshjes 0.5 mm më thellë se gjërësia e llastikut.
- të qepë dy tegela në dy skajet e palosjes.
- të lërë në tegelin e poshtëm hapsirën prej 2.5 m për futjen e llastikut.
- të presë llastikun pak më të shkurtër se perimetri i belit plus 1 cm për bashkimin.
- të shkojë llastikun me gjilpërë-kapëse.

- të qepë llastikun duke mbivendosur skajet 1 cm
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjierno-sanitare
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 5 Nxënësi qep linjën e belit me rrudha nëpërmjet fjongos së kaluar.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen e linjës së belit me rrudha nëpërmjet fjongos.
- Qepja e vrimës për fjongon.
- Kthimi i pjesës së lartme të veshjes.
- Qepja me dy tegela paralel të pjesës së kthyer.
- Futja e fjongos në tunel.
- Lidhja e fjongos.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e linjës së belit me llastik.
- të qepë vrimën për fjongo, me dorë ose makinë.
- të kthejë pjesën e lartme të veshjes sa gjërësia e fjongos plus 2.5 cm për pjesën mbi fjongo.
- të qepë dy tegela paralele me një gjërësi 0.5 mm më shumë se gjërësia e fjongos.
- të qepë me dy skajet e fjongos (e cila futet brënda) llastik, për të qëndruar më mirë veshja.
- të kalojë nga bira në tunel nëpërmjet gjilpërës-kapëse rrethe qark belit fjongon.
- të lidhë fjongon
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjierno-sanitare
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të rrobaqepësisë dhe rekomandohet të organizohen vizita njohëse ne ndermarrje të rrobaqepësisë
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për përgatitjen dhe qepjen e qemerëve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për përgatitjen dhe qepjen e qemerëve të thjeshtë, me forma dhe me llastik, si dhe për qepjen e linjës së belit me mostër.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e

	<p>rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi përgatitjen dhe qepjen e qemerëve në veshje.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - repart rrobaqepsie; - pajisjet dhe mjetet e punës së rrobaqepësit; - lëndë të para dhe ndihmëse për prerjen dhe qepjen e qemerëve. - pankarta, makete, udhëzues, katalogë të rrobaqepsisë, etj.

3. Moduli “Qepja e mostrave”

Drejtimi: Tekstil - konfeksione

Niveli: I

Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	QEPJA E MOSTRAVE	M-10-067-08
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të përgatitur mostra dhe për t'i qepur ato në pjesë të ndryshme të veshjeve.	
Kohëzgjatja e modulit	34 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 të drejtimit “Tekstil-konfeksione”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi qep mostrën e harkut të qafës.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse të punës.- Frazelinimi i pjesëve të mostrës.- Qepja e supeve të mostrës.- Hekurosja e bashkimit të supeve.- Prerja e qosheve të bashkimit të supeve.- Pastrimi i pjesës së jashtme të mostrës.- Ildisja e mostrës në harkun e qafës.- Palosja e dy skajeve të mostrës në hapjen e shpinës së veshjes.- Qepja e mostrës.- Heqja e tepicave- Cikatja e harkut të qafës.- Drejtimi i mostrës.- Qepja e tegelit të sipërm.- Kthimi i mostrës.- Rrotullimi i mostrës.- Ildisja e mostrës.- Qepja e palosjes së mostrës në hapjen e shpinës.- Fiksimi e mostrës në supe.- Heqja e ildive.- Hekurosja e mostrës.- Pastrimi i vendit të punës- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p>	

-
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për të qepur mostrën e harkut të qafës.
 - të përzgjedhë materialeve ndihmëse të punës.
 - të frazelinojë pjesët e mostrës.
 - të qepë supet e mostrës.
 - të hapë me hekur bashkimin e supeve.
 - të presë qoshet e bashkimit të supeve.
 - të pastrojë pjesën e jashtme të mostrës më makinë ose me gërshërë të dhëmbëzuara.
 - të ildisë mostrën në harkun e qafës.
 - të palosë dy skajet e mostrës në hapjen e shpinës së veshjes.
 - të qepë me makinë mostrën.
 - të heqë tepricat e mostrës së qepur
 - të cikasë harkun e qafës.
 - të drejtojë mostrën sipas harkut të qafës.
 - të qepë tegelin e sipërm në buzë të mostrës.
 - të kthejë mostrën.
 - të rrotullojë lehtë mostrën.
 - të ildisë mostrën.
 - të qepë palosjet anësore të mostrës në hapjen e shpinës.
 - të fiksojë mostrën në supe.
 - të heqë ilditë.
 - të hekurosë mostrën.
 - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjeno-sanitare.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi qep mostrën e dekoltesë në formë V-je.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse të punës.
- Frazelinimi i pjesëve të mostrës.
- Qepja e supeve të mostrës.
- Hekurosja e bashkimit të supeve.
- Prerja e qosheve të bashkimit të supeve.
- Pastrimi i pjesës së jashtme të mostrës.
- Ildisja e mostrës në harkun e qafës.
- Qepja e mostrës.
- Prerja e qoshit tek V-ja
- Cikatja e harkut të qafës.
- Kthimi i mostrës.
- Rrotullimi i mostrës.
- Ildisja e mostrës.
- Fiksimi i mostrës në supe.
- Heqja e ildive.
- Hekurosja e mostrës.
- Pastrimi i vendit të punës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes

së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për të qepur mostrën e dekoltesë në formë V-je.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse të punës.
- të frazelinojë pjesët e mostrës.
- të qepë supet e mostrës.
- të hapë me hekur bashkimin e supeve.
- të presë qoshet e bashkimit të supeve.
- të pastrojë pjesën e jashtme të mostrës më makinë ose me gërshërë të dhëmbëzuara.
- të ildisë mostrën në harkun e qafës.
- të qepë mostrën duke mbajtur gjilpërën në pëlhurë në pikën e V-së.
- të qepë një hap tegeli tërthorazi V-së.
- të rroullojë pëlhurën rreth gjilpërës dhe të vazhdojë qepjen e mostrës.
- të presë qoshin tek V-ja
- të cikisë harkun e qafës.
- të kthejë mostrën.
- të rrotullojë mostrën.
- të ildisë mostrën
- të fiksojë mostrën në supe.
- të heqë ilditë.
- të hekurosë mostrën e qepur në veshje.
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjeno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi qep mostrën e gavaturës.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen e mostrës së gavaturës.
 - Përzgjedhja e materialeve ndihmëse të punës.
 - Frazelinimi i pjesëve të mostrës.
 - Qepja e supeve dhe e pjesës anësore të mostrës.
 - Hekurosja e bashkimit të supeve dhe e pjesës anësore.
 - Pastrimi i pjesës së jashtme të mostrës.
 - Ildisja e mostrës në harkun e gavaturës.
 - Qepja e mostrës në harkun e gavaturës.
 - Cikajtja e harkut të gavaturës.
 - Kthimi i mostrës.
 - Rrotullimi i mostrës
 - Ildisja e mostrës.
 - Fiksimi i mostrës.
 - Heqja e ildive.
 - Hekurosja e mostrës.

- Pastrimi i vendit të punës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për të qepur mostrën e gavaturës
- të përzgjedhë materialet ndihmëse të punës.
- të frazelinojë pjesët e mostrës.
- të qepë supet dhe pjesën anësore të mostrës.
- të hapë me hekur bashkimin e supeve dhe të pjesës anësore.
- të pastrojë pjesën e jashtme të mostrës më makinë ose me gërrshërë të dhëmbëzuara.
- të ildisë mostrën në harkun e gavaturës.
- të qepë mostrën në harkun e gavaturës.
- të cikisë harkun e gavaturës.
- të kthejë mostrën.
- të rrotullojë lehtë mostrën.
- të ildisë mostrën.
- të fiksojë mostrën në supe dhe në rafinë anësore të veshjes.
- të heqë ilditë.
- të hekurosë mostrën e qepur.
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjeno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi qep mostrën e kombinuar të qafës dhe gavaturës.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen e mostrës së kombinuar të qafës dhe gavaturës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse të punës.
- Frazelinimi i pjesëve të mostrës.
- Qepja e supeve të mostrës
- Hekurosja e bashkimit të supeve.
- Pastrimi i pjesës së jashtme të mostrës.
- Ildisja e mostrës në harkun e qafës.
- Qepja e mostrës në harkun e qafës.
- Cikatja e harkut të qafës.
- Kthimi i mostrës.
- Hekurosja e mostrës.
- Kthimi i veshjes në anën e mbarë.
- Pozicionimi i mostrës.
- Qepja e mostrës në supe
- Cikatja e harkut të gavaturës.
- Ildisja e mostrës rreth gavaturës.
- Fiksimi i mostrës në rafinë anësore.

- Heqja e ildive.
- Hekurosja e mostrës.
- Pastrimi i vendit të punës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për të qepur mostrën e kombinuar të qafës dhe gavaturës.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse të punës.
- të frazelinojë pjesët e mostrës.
- të qepë supet e mostrës dhe pjesët anësore të mostrave.
- të hapë me hekur bashkimin e supeve dhe të pjesëve anësore.
- të pastrojë pjesën e jashtme të mostrës.
- të ildisë mostrën në harkun e qafës.
- të qepë mostrën në harkun e qafës.
- të cikasë harkun e qafës.
- të kthejë mostrën, duke e rrotullar atë në pjesën e brendëshme të veshjes.
- të shtypë me hekur mostrën.
- të kthejë veshjen nga ana e mbarë.
- të pozicionojë mostrën duke bashkua nga ana e mbarë mostrën dhe veshjen.
- Të qepë mostrën nga supi poshtë e përsëri në sup duke tërhequr veshjen.
- të cikasë harkun e gavaturës.
- të ildisë mostrën rreth gavaturës, pasi ta ketë kthyer dhe rrotullar lehtë atë
- të fiksojë mostrën në rafinë anësore.
- të hekurosë mostrën.
- të heqë ilditë.
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 5 Nxënësi qep mostrën e paprerë.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen e mostrës së paprerë.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse të punës.
- Frazelinimi i përparëseve të mostrës së paprerë.
- Frazelinimi i mostrës së shpinës.
- Qepja e supeve të mostrave
- Hekurosja e bashkimit të supeve.
- Pastrimi i pjesës së jashtme të mostrës.
- Ildisja e mostrës në harkun e qafës.
- Qepja e mostrës në harkun e qafës.

- Cikatja e harkut të qafës.
- Kthimi i mostrës.
- Rrotullimi i mostrës.
- Ildisja i mostrës.
- Palosja e mostrës në fundin e veshjes.
- Qepja me dorë e palosjes.
- Fiksimi i mostrës në supe.
- Heqja e ildive.
- Hekurosja e mostrës.
- Pastrimi i vendit të punës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për të qepur mostrën e paprerë.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse të punës.
- të frazelinojë pjesët e mostrës së paprerë
- të frazelinojë mostrën e shpinës.
- të qepë supet e mostrave të përparëses me supet e mostrës së shpinës.
- të hapë me hekur bashkimin e supeve dhe anëve të përparëseve
- të pastrojë pjesën e jashtme të mostrës.
- të ildisë mostrën në harkun e qafës.
- të qepë mostrën në harkun e qafës.
- të cikasë harkun e qafës.
- të kthejë mostrën.
- të rrotullojë mostrën
- të ildisë mostrën
- të palosë pjesën fundore të mostrës mbi palën e kthyer.
- të qepë me dorë palosjen.
- të krijojë një ngritje 0.5 cm në fund të mostrës.
- të fiksojë mostrën në supe.
- të heqë ilditë.
- të hekurosë mostrën.
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjeno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të rrobaqepsisë.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për përgatitjen dhe qepjen e mostrave të harqeve të qafës, gavaturës, të mostrave të kombinuara si dhe të mostrave të paprera.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për përgatitjen dhe qepjen e mostrave.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave

të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi përgatitjen dhe qepjen e mostrave të harqeve të qafës, gaturës, të mostrave të kombinuara si dhe të mostrave të paprera.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- reparat rrobaqepsie;
- pajisjet dhe mjetet e punës së rrobaqepësit;
- lëndë të para dhe ndihmëse për përgatitjen dhe qepjen e mostrave
- pankarta, makete, udhëzues, katalogë të rrobaqepësisë, etj.

4. Moduli “Konfeksionimi i fund-pantallonave”

Drejtimi: Tekstil - konfeksione

Niveli: I

Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KONFEKSIONIMI I FUND-PANTALLONAVE	M-10-068-08
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të konfeksionuar fund-pantallonat.	
Kohëzgjatja e modulit	34 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 të drejtimit “Tekstil-konfeksione”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi ndërton kallëpet për fund-pantallona të thjeshta Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.- Marrja e përmasave për ndërtimin e kallëpeve të fund-pantallonave të thjeshta.- Nxjerrja e masave të nevojshme për fund-pantallona, nga tabela e përmasave.- Ndërtimi i skicave të prerjes së fund-pantallonave.- Kontrolli i saktësisë së skicave.- Ndërtimi i kallëpeve bazë të fund-pantallonave të thjeshta.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prerjen e fund-pantallonave të thjeshta.- të marrë masat në trup për fund pantallonat e thjeshta- të nxjerrë nga tabela e përmasave masat e nevojshme për fund-pantallona.- të ndërtojë skicat e prerjes së fund-pantallonave të thjeshta sipas masave të nevojshme.- të kontrollojë saktësinë e skicave të ndërtuara.- të ndërtojë kallëpe bazë të fund-pantallonave të thjeshta.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.	

RM 2 Nxënësi pret kallëpet për fund-pantallona të modeluara.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.

- Marrja e masave për ndërtimin e kallëpeve të fund-pantallonave të modeluara.
- Nxjerrja e masave për fund-pantallona të modeluara, nga tabela e përmasave.
- Ndërtimi i kallëpeve të fund-pantallonave të gjëra poshtë dhe të shkurta.
- Ndërtimi i kallëpeve të fund-pantallonave të gjëra poshtë dhe të gjata.
- Ndërtimi i kallëpeve të fund-pantallonave me rrotullim
- Ndërtimi i kallëpeve të fund-pantallonave me palë (gufopiet)
- Ndërtimi i kallëpeve të fund-pantallonave me dy pala
- Ndërtimi i kallëpeve të fund-pantallonave me palë dhe supanja.
- Kontrolli i kallëpeve të fund pantallonave
- Vendosja e shenjave të referimit.
- Përgatitja e pëlhurës për prerje.
- Vendosja e kallëpeve mbi pëlhurë
- Shënimi mbi pëlhurë i pjesëve të fund-pantallonave.
- Prerja e pëlhurës.
- Prerja e përforcuesit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prerjen e fund-pantallonave të modeluara.
- të marrë masat në trup për ndërtimin e fund pantallonave të modeluara.
- të nxjerrë masat për fund-pantallona të modeluara, nga tabela e përmasave.
- të ndërtojë kallëpet e fund-pantallonave të gjëra poshtë dhe të shkurtra, sipas masave të nxjerra.
- të ndërtojë kallëpet e fund-pantallonave të gjëra poshtë dhe të gjata, sipas masave të nxjerra.
- të ndërtojë kallëpet e fund-pantallonave me rrotullim.
- të ndërtojë kallëpet e fund-pantallonave me palë (gufopjet) në pjesën e përparme.
- të ndërtojë kallëpet e fund-pantallonave me dy pala në të njëjtin drejtim në pjesën e përparme.
- të ndërtojë dhe të presë kallëpet e fund-pantallonave me palë dhe supanja.
- të bëjë kontrollin e saktësisë së kallëpeve të fund-pantallonave me palë dhe supanja.
- të vendosë shenjat përkatëse të referimit.
- të përgatisë pëlhurën për prerje.
- të vendosë saktë kallëpet mbi pëlhurë.
- të shënojë saktë mbi pëlhurë pjesët e fund-pantallonave.

- të presë në pëlhurë shpinën, përparësen, supanajat e shpinës dhe përparëses dhe qemerin.
- të presë përforcuesit e supanjave të shpinës dhe përparëses dhe qemerit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi përgatit fund-pantallonin për provën e parë

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Kopjimi i shënimeve nga pjesa e lartme në atë të poshtme.
- Frazelinimi i supanjave dhe qemerit.
- Ildisja e pjesëve të përparme.
- Ildisja e palës gufopjet tek përparësja.
- Ildisja e pjesëve të shpinës.
- Ildisja e supanjave tek shpina dhe përparësja.
- Ildisja e shpinës me përparësen e fund-pantallonit.
- Kryerja e provës së parë.
- Rregullimi i fund-pantallonit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për provën e parë të fund-pantallonave.
- të kopjojë me penjë-kopjues shënimet nga pjesa e lartme në atë të poshtme.
- të frazelinojë supanajat dhe qemerin.
- të ildisë pjesët e përparme.
- të ildisë palës gufopjet tek përparësja.
- të ildisë pjesët e shpinës.
- të ildisë supanajat në shpinën dhe përparësen e fund-pantallonave.
- të ildisë shpinën me përparësen e fund-pantallonave.
- të kryejë provën e parë të qëndrimit në trup të fund-pantallonave.
- të rregullojë fund-pantallonat, pas kryerjes së provës së parë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi përgatit fund-pantallonin për provën e dytë

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Bashkimi i shpinave.
- Qepja e shpinave.
- Bashkimi i përparëseve.

- Qepja e përparëseve
- Qepja e palës së përparëses.
- Hekurosja e shpinës dhe përparëses.
- Përgatitja e supanjave.
- Hekurosja e supanjave të përgatitura.
- Montimi i supanjave.
- Bashkimi i shpinës me përparësen e fund-pantallonave
- Qepja e xhepave anësorë
- Qepja e zinxhirit.
- Ildisja e qemerit.
- Kryerja e provës së dytë
- Shënimi i palës së fund-pantallonave.
- Rregullimi fund-pantallonave.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për provën e dytë të fund-pantallonave.
- të bashkojë shpinat
- të qepë shpinat.
- të bashkojë përparëset.
- të qepë përparëset.
- të qepë palën e përparëses.
- të hekurosë shpinën dhe përparësen.
- të përgatisë supanjat.
- të hekurosë supanjat e përgatitura.
- të bashkojë supanjat me shpinën dhe përparësen e fund-pantallonave.
- të bashkojë, saktë, shpinën me përparësen e fund-pantallonave.
- të qepë xhepat në bashkimin anësor.
- të qepë zinxhirin në anën e majtë të fund-pantallonave.
- të ildisë qemerin.
- të kryejë provën e dytë të qëndrimit në trup të fund-pantallonave
- të shënojë palën e fund-pantallonave, mbi bazën e provës
- të rregullojë fund-pantallonat pas kryerjes së provës së dytë
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 5 Nxënësi kryen proceset përfundimtare të qepjes së fund - pantallonave.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Qepja e qemerit.

- Ildisja e palës
- Qepja e palës.
- Qepja e vrimës së kopsës në qemer.
- Qepja e qemerit.
- Hekurosja e qemerit.
- Vendosja e kopsës në qemer.
- Vendosja e ylykëve në qemer.
- Hekurosja përfundimtare.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së fund-pantallonit.
- të qepë qemerin me tegel.
- të ildisë palën sipas shënimit
- të qepë palën.
- të qepë vrimën për kopsë në qemer me dorë ose makinë.
- të qepë qemerin me tegel të sipërm.
- të hekurosë qemerin.
- të vendosë saktë kopsën në qemer.
- të vendosë ylykët mbajtës në qemer.
- të hekurosë përfundimisht fund-pantallonat.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të rrobaqepsisë
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për prerjen dhe qepjen e fund-pantallonave.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për prerjen dhe qepjen e fund-pantallonave.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi ndërtimin e kallëpeve të pjesëve përbërëse të fund-pantallonave të thjeshta.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi zbërthimin e modeleve dhe ndërtimin e kallëpeve të pjesëve përbërëse të fund-pantallonave të modeluara.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kontrollin e saktësisë së kallëpeve të fund-pantallonave, vendosjes së tyre në pëlhurë dhe prerjes së pëlhurës.

-
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi qepjen e fund-pantallonave.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kryerjen e provave të para dhe të dyta si dhe në mënyrën e rrugullarjes pas provës.
-

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- repart rrobaqepsie;
 - pajisjet dhe mjetet e punës së rrobaqepësit;
 - lëndë të para dhe ndihmëse për prerjen dhe qepjen e fund-pantallonave.
 - pankarta, makete, udhëzues, katalogë të rrobaqepsisë, etj.
-

5. Moduli “Konfeksionimi i fustaneve”

Drejtimi: Tekstil - konfeksion

Niveli: I

Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KONFEKSIONIMI I FUSTANEVE	M-10-069-08
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të konfeksionuar fustane të llojeve të ndryshme.	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 të drejtimit “Tekstil-konfeksione”	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi merr masat për fustanin <i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e mjeteve të punës për marrjen e masave.- Marrja e masave për fustan.- Kontrolli i masave për fustan.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë mjetet e punës për marrjen e masave.- të marrë masat në trupin e njeriut- të kontrollojë masat e marra.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>RM 2 Nxënësi pret fustanin për femra. <i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për prerjen e fustanit.- Skicimi i fustanit të thjeshtë.- Kontrolli i skicave.- Prerja e kallëpeve të fustanit të thjeshtë.- Vendosja e shenjave përkatëse të referimit.- Përgatitja e pëlhurës për prerje- Vendosja e kallëpeve mbi pëlhurë.- Shënimi mbi pëlhurë i pjesëve të fustanit.- Shënimi i rezervave të qepjes.- Prerja e pëlhurës.- Prerja e frazelinës.	

- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prerjen e fustanit.
- të skicojë pjesët e fustanit të thjeshtë.
- të kontrollojë saktësinë e skicave.
- të presë kallëpet e fustanit të thjeshtë.
- të vendosë shenjat e referimit.
- të përgatisë pëlhurën për prerje, duke e palosur atë në drejtim gjatësor, nga ana e mbarë e saj.
- të vendosë kallëpet mbi pëlhurë në drejtim të bazës së pëlhurës.
- të shënojë mbi pëlhurë pjesët e fustanit.
- të shënojë rezervat e qepjes.
- të presë në pëlhurë pjesët përbërëse të fustanit.
- të presë në frazelinë mostrat për dekoltenë e fustanit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi përgatit fustanin për provën e parë

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për provën e parë të fustanit.
- Kopjimi i shënimeve.
- Frazelinimi i mostrave të harkut të qafës.
- Ildisja e fustanit.
- Kryerja e provës së parë.
- Rregullimi i fustanit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për provën e parë të fustanit.
- të kopjojë me penjë-kopjues shënimet nga pjesa e lartme në atë të poshtme tek shpina dhe përparësja e fustanit.
- të frazelinojë mostrat
- të ildisë pensat e fustanit.
- të bashkojë me ildi shpinën me përparësen e fustanit.
- të kryej provën e parë të qëndrimit në trup të fustanit.
- të kryej rregullimin e fustanit pas kryerjes së provës së parë
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi përgatit fustanin për provën e dytë

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen e fustanit deri në provën e dytë.
- Qepja e pensave të shpinës dhe përparëses së fustanit.
- Hekurosja e pensave.
- Qepja e shpinës me përparësen e fustanit.
- Përgatitja e mostrave për dekoltenë.
- Hekurosja e pjesëve anësore të fustanit.
- Përgatitja e mostrave për dekoltenë e fustanit.
- Qepja e mostrave.
- Përgatitja e mëngëve.
- Ildisja e mëngëve.
- Kryerja e provës së dytë.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e fustanit deri në provën e dytë të tij.
- të qepë pensat e shpinës dhe përparëses së fustanit me tegel.
- të hekurosë pensat.
- të qepë me makinë shpinën me përparësen e fustanit.
- të hekurosë pjesët anësore të fustanit.
- të përgatisë mostrat për dekoltenë e fustanit.
- të qepë mostrat në dekoltenë e fustanit.
- të mbyllë mëngët me makinë.
- të kthejë palën e mëngëve
- të qepë tegelat e mulesave tek koka e mëngës.
- të ildisë mëngën në fustan.
- të kryej provën e dytë të qëndrimit në trup të fustanit.
- të kryej rregullimin e fustanit pas kryerjes së provës
- të shënojë palën e fustanit
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi kryen proceset përfundimtare të qepjes së fustanit.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së fustanit.
- Qepja e zinxhirit
- Qepja e mëngëve.
- Qepja e palës së fustanit.
- Dekorimi i dekoltesë.
- Izolimi i penjëve.

- Pastrimi i fustanit.
- Hekurosja përfundimtare
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së fustanit.
- të qepë zinxhirin në pjesën anësore të fustanit.
- të qepë mëngët me makinë në harkun e gavaturës.
- të ildisë palën e fustanit.
- të qepë me dorë palën e fustanit dhe të mëngës.
- të dekorojë me tegel të sipërm dekoltenë.
- të izolojë me dorë ose makinë penjtë e pëlhurës në pjesën e brendëshme të fustanit.
- të pastrojë fustanin nga penjtë.
- të hekurosë fustanin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të rrobaqepsisë
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për prerjen dhe qepjen e fustanit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për prerjen dhe qepjen e fustanit.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi prerjen e pjesëve përbërëse të fustanit në pëlhurë dhe fortesë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi qepjen e fustanit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- repart rrobaqepsie;
 - pajisjet dhe mjetet e punës së rrobaqepësit;
 - lëndë të para dhe ndihmëse për prerjen dhe qepjen e fustanit.
 - pankarta, makete, udhëzues, katalogë të rrobaqepsisë, etj.
-

6. Moduli “Thurrje me grep dhe me shtiza”

Drejtimi: Tekstil - konfeksion

Niveli: I

Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	THURRJE ME GREP DHE ME SHTIZA	M-10-070-08
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari përgatitore për përdorimin e grepit dhe shtizave.	
Kohëzgjatja e modulit	34 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 të drejtimit “Tekstil-konfeksione”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen procese përgatitore për përdorimin e grepit.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës grepin dhe shtizat.- Përzgjedhja e grepit.- Përzgjedhja e fillit.- Mbatja e grepit.- Mbatja e fillit.- Tërheqja e fillit.- Kalimi i fillit nga gishti në grep.- Krijimi i lakut.- Zbërthimi i modelit.- Punimi i zinxhirit.- Punimi i lakut për mbushje.- Realizimi i mbushjes pa lak.- Realizimi i mbushjes me një lak.- Realizimi i mbushjes me dy laqe.- Llogaritja e kutive.- Llogaritja e mbushjeve.- Zjedhja e modeleve.- Zbërthimi i modeleve.- Realizimi i dizenjës.- Aftësimi i modele të ndryshme.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përdorimin	

-
- e grepit.
 - të zgjedhë grepin sipas numërit të kërkuar sipas llojit të fillit.
 - të zgjedhë fillin sipas numërit të kërkuar.
 - të mbajë si duhet grepin në dorë.
 - të mbajë si duhet filli në dorë.
 - të llogarisë masën e tërheqjes së fillit.
 - të kalojë fillin nga gishti në grep nëpërmjet krijimit të lakut.
 - të krijojë lakun.
 - të zërthejë modelin e kërkuar.
 - të ndërthurë fillin me grep për të punuar zinxhirin.
 - të punojë mbushjen me grep duke zgjatur lakun e fillit.
 - të realizojë mbushjen me grep pa lak.
 - të realizojë mbushjen me grep me një lak.
 - të realizojë mbushjen me grep me dy laqe.
 - të llogarisë sasinë e zinxhirit për numërin e kutive.
 - të llogarisë sasinë e mbushjeve sipas modelit.
 - të zgjedhë modelin sipas kërkesave.
 - të zërthejë modelin.
 - të realizojë dizenjon e dhënë.
 - të zërthejë dizenjo të ndryshme me grep.
 - të zbatojë rregullat te sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi kryen procese përgatitore për përdorimin e shtizave.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për punimin me shtiza.
- Zgjedhja e numërit të shtizave.
- Zgjedhja e numërit të fijeve.
- Mbajtja e shtizave.
- Mbajtja e fillit.
- Kalimi i sythave në shtizë.
- Tërheqja e fillit.
- Kalimi i sythave nëpër shtiza.
- Përzjedhja e modelit.
- Llogaritja e sythave sipas modelit.
- Punimi llastik.
- Punimi çorap.
- Realizimi i modelit.
- Zgjerimi (shtimi) i sythave.
- Mbyllja e sythave.
- Zbërthimi i modeleve të ndryshme.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për punimin me shtiza sipas procedurave standarde.
- të zgjedhë numërin e shtizave sipas modelit dhe numërit të fillit.
- të zgjedhë numërin e fillit sipas numërit të shtizave.
- të dijë si mbahen shtizat në dorë.
- të mbajë si duhet fillin në dorë e në qafë.
- të realizojë fillimin e modelit në shtizë.
- të llogarisë sasinë e tërheqjes së fillit.
- të kalojë sythat nga një shtizë në tjetrën nëpërmjet krijimit të lakut.
- të realizojë modelin sipas të dhënave.
- të llogarisë sythat sipas modelit të kërkuar.
- të realizojë punimin llastik.
- të realizojë punimin çorap.
- të zgjedhë modelin sipas kërkesave.
- të shtojë sythat.
- të mbyllë sythat.
- të zbërthejë modele të ndryshme.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të punimit me dorë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve përgatitore për përdorimin e grepit dhe shtizave.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për përdorimin e mjeteve të punës për punimin me grep dhe atë me shtiza.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit .
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e punimit me grep dhe atij me shtiza.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- reparti i punimit me dorë.
 - shtiza me numër të ndryshëm
 - grepa me numëra të ndryshëm.
 - numëra të ndryshëm filli, pambuk dhe akrilik.
 - katalog dhe revista me modele të ndryshme për punim me grep dhe atë me shtiza.
-